

Nëntor 2002

**Sistemi Statistikor i Kosovës**  
**Propozimi i planit zhvillimor**

**Projekti i Bankës Botërore**

**Börje Dernulf , Sten-Åke Hallén,  
B-J Management AB  
Suedi**

## Përmbajtja

<b>1 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE</b>	<b>3</b>
<b>2 HISTORIKU DHE PARATHËNJA</b>	<b>7</b>
<b>3 STATISTIKAT ZYRTARE DHE FUNKSIONET E SISTEMIT STATISTIKOR</b>	<b>8</b>
3.1 ROLI I INFORMACIONIT	7
3.2 FUNKSIONET KRYESORE TË SISTEMIT INFORMATIV STATISTIKOR	8
3.3 STATISTIKAT ZYRTARE	9
<b>4 REZULTATET E PËRGJITHSHME, SYNIMET AFAT-MESME DHE PRIORITETET</b>	<b>10</b>
<b>5 PRODHIMI STATISTIKOR-PROJEKTET E PROPOZUARA</b>	<b>12</b>
5.1 RENDITJA	12
5.2 STATISTIKAT E POPULLSISË	12
5.3 STATISTIKAT EKONOMIKE	15
5.4 TË BUJQËSISË DHE AMBIENTIT	17
5.5 STATISTIKAT SOCIALE	20
5.6 STATISTIKAT SHUMË-FUSHORE	22
5.7 PROJEKTET MBI INFOLOGJINË, BAZËN E TË DHËNAVE DHE SHPËRNDARJEN	23
<b>6 NDËRTIMI I KAPACITETIT</b>	<b>25</b>
6.1 PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE TRAJNIMI MBI MENAXHIMIN	25
6.2 TI DHE METODAT STATISTIKORE	26
<b>7 ÇËSHTJET E KOORDINIMIT, RREGULLATIVËS LIGJORE, AKTIVITETET EPËRKRAHJES</b>	<b>27</b>
7.1 HYRJA	27
7.2 PROPOZIMET	27
<b>8 PËRMBLEDHJA E PROPOZIMIT; FINANCIMI DHE ITINERARI</b>	<b>30</b>
<b>9 REALIZIMI I PLANIT ZHVILLIMOR</b>	<b>35</b>
9.1 KOORDINIMI I DONATORËVE	35
9.2 KALIMI NGA PLANI ZHVILLIMOR NË ATE EKZEKUTUES	35
9.3 ÇËSHTJET QEVERITARE	35
9.4	
<b>10 SHTOJCAT</b>	<b>36</b>
10 KUSHTET E REFERENCËS	36
10.1 ENTI I STATISTIKËS I KOSOVËS (ESK)-PËRSHKRIM I SHKURTËR	36
10.2 PERSONAT E KONTAKTUAR	36
10.3 AGJENDA E TAKIMEVE ME SHFRYTËZUESIT/PRODHUESIT	36
10.4 VLERËSIMET E SHPENZIMEVE	36

## 1 Përmbledhja ekzekutive

### Statistikat e sotme në Kosovë

Informacionet statistikore në Kosovë janë të shkapërderdhura dhe jo komplete. Ka mungesë të të dhënave elementare mbi popullsinë, punësinë, biznesin dhe shfrytëzimin e pronave/tokave-gjendjen dhe trendet. Statistikat zyrtare janë të pakta për shkak të konfliktit dhe ndyshimit të sistemit politik. Në ekonominë e tregut janë të nevojshme të dhëna tjera, veçanarisht në fushën e ekonomisë. Meqenëse ekzistojnë zbrazësi të theksuara në statistikat zyrtare, është theksuar nevoja për burimet tjera të informimit qoftë edhe për ato të përkohshme. Një anketë ad-hok e zëvendëson prodhimin e rregullt të statistikave. Kjo situatë mundëson inkuadrimin e prodhuesëve të ndryshëm të të dhënave, të cilët shpesh janë të pakoordinuar në aspektin e prodhimit, metodave dhe standardeve. Qasja e të dhënave paraqitet si problem për shkak të shumë prodhuesëve dhe publikimeve të pakta.

Ministritë dhe agjencionet tjera publike, OJQ-të, sektori privat, media dhe publiku i gjërë po kërkojnë më shumë të dhëna lidhur me gjendjen dhe trendet në ekonomi dhe kushtet e jetesës. Ekzistojnë burime shumë të kufizuara për prodhimin e statistikave; nuk ka strategji për zhvillimin e sistemit dhe nuk ka dijeni të mjaftueshme për disajnimin e një sistemi modern. Megjithate, ekziston motivimi i fuqishëm për zhvillimin e metodave dhe sistemeve të reja si dhe përkrahja e fuqishme për aplikimin e standardeve ndërkombëtare. Enti i Statistikës i Kosovës për një kohë të shkurtër e themeloi organizatën dhe bëri një fillim të mirë të punës për mbulimin e zbaztsive informative.

### Statistikat zyrtare dhe funksionet e sistemit statistikor

Janë përshkruar roli dhe definicioni i statistikave zyrtare. Janë prezentuar funksionet e sistemit statistikor si dhe parakushtet e statistikave të mira.

### Drejtimi që duhet ndjekur

Plani zhvillimor në fillim të ndërtimit të kontrolluar të një sistemi statistikor gjithpërfshirës dhe të qëndrueshëm, përmes tri kanaleve kryesore, synon:

- Zhvillimin e prodhimit të statistikave
- Ndërtimin e kapaciteteve
- Koordinimin e prodhimit, metodave dhe standardeve

Gjatë këtij tranzicioni ju poashtu duhet ta ndërtoni besimin në administratë dhe të ngritni njohuritë mbi vlerën e statistikave zyrtare dhe të paanshme. Ky është kusht shumë i rëndësishëm për sigurimin e të dhënave të besueshme nga individët, firmat, etj.

### Zhvillimi i prodhimit të statistikave

Detyra më e rëndësishme mund të formulohet si dhënie të të dhënave më të mira makro ekonomike për sajuesit e politikave. Kjo detyrë nuk mund të plotësohet në mënyrë të kënaqshme vetëm me të dhënat nga bizneset. Të dhënat mbi popullsinë dhe sektorin e bujqësisë poashtu janë të nevojshme. Andaj, ndërtimi i të dhënave

themelore duhet të realizohet përmes aktiviteteve paralele në tri fushat kryesore statistikore: popullsisë, bizneseve dhe pronave/bujqësi.

Statistikat e popullsisë Bazën e të gjitha statistikave zyrtare e paraqet regjistrimi komplet i popullsisë dhe banesave, i cili është prioritet evident i pazëvendësueshëm. Planifikimi i regjistrimit të popullsisë në vitin 2004 është në zhvillim e sipër dhe për këtë qëllim është përgatitur ligji i posaçëm. Regjistrimi i popullsisë paraqet një ndërmarrje shumë të madhe dhe, megjithëse është përgjegjësi e natyrshme e ESK, duhet të realizohet si projekt i veçantë. Donatorë të ndryshëm kanë shprehur vullnetin për të financuar këtë regjistrim, prandaj ai nuk është përfshirë në buxhetin e propozuar me këtë projekt.

Statistikat ekonomike. Llogaritë kombëtare pasqyrojnë gjendjen dhe trendet e makro-ekonomisë së një vendi. Ky është, poashtu, një sistem përmes së cilit mund të integrohen dhe harmonizohen statistikat e sektorëve të ndryshëm të biznesit. Trajnimi, me qëllim të ndërtimit të një sistemi të qëndrueshëm të llogarive kombëtare në përputhje me metodologjinë e BE, zë vend prioritar në këtë plan për të cilin janë paraparë burimet adekuate. Krahas ndërtimit të dijës know-how përkritazi me llogaritë kombëtare, duhet të prodhohen statistikat e sektorëve të biznesit. Krijimi i instrumenteve për grumbullimin e të dhënave është i domosdoshëm, andaj edhe është propozuar një program për anketat e rregullta të bizneseve.

Statistikat e bujqësisë dhe të ambientit. Sektori i bujqësisë është pjesë e rëndësishme e ekonomisë, me rreth 30% pjesëmarrje në BPP. Janë duke u zhvilluar anketat e rregullta, por të dhënat themelore komplete do të mungojnë edhe më tej derisa të realizohet një regjistrim i bujqësisë. Data më e hershme e mundshme për realizimin e një regjistrimi të bujqësisë është viti 2006, nëse më parë realizohet regjistrimi i popullsisë në vitin 2004. Përkritazi me statistikat e ambientit është propozuar që të fillohet me një studim mbi arsyeshmërinë-çfarë mundet dhe çka duhet të bëhet lidhur me matjen dhe përshkrimin e gjendjes së ambientit. Në këtë kontekst, duhet të hulumtohet potenciali statistikor në të ardhmen për një regjistër mbi pronat.

Statistikat sociale. Janë realizuar anketat e fuqisë punëtore dhe anketat e buxhetit të ekonomive shtëpiake. Duhet të elaborohet programi i anketave të rregullta ndërsa koha e prodhimit duhet të shkurtohet. Të dhënat nga këto anketa i formojnë inputet e rëndësishme për statistikat ekonomike dhe poashtu mund të përdoren për përshkrim të gjithmbarshëm të kushteve të jetesës siç janë: varfëria, shëndetësia dhe arsimi. Kjo punë është realizuar dhe ka filluar prodhimi i statistikave të arsimit, kulturës, kujdesit shëndetësor dhe krimit, mbështetur në burimet administrative. Ky aktivitet duhet inkurajuar dhe forcuar.

Statistikat për shumë fusha. Autoritetet komunale dhe rajonale theksojnë nevojat për statistika sipas shpërndarjes gjeografike. Sistemi i mëparshëm i ndarjeve rajonale, madje edhe nën nivelin komunal, duhet të reaktivizohet. Me qëllim të plotësimit të disa zbrazësive lidhur me përshkrimin më të gjërë dhe promovimin e “statistikave në shoqëri”, duhet të inkurajohen publikimet inter-sektorale-në formë të vjetarit apo buletineve mujore. Në

këtë kontekst, lansimi i veb-sajtit të ESK poashtu është i rëndësishëm. Për monitorimin e zhvillimit të përgjithshëm të një vargu indikatorësh të zbatimit, ato duhet të vlerësohen dhe vëhën në prodhim.

**Studimet për zhvillimin e Sistemit Statistikor.** Me qëllim të studimit të Sistemit të ardhshëm Statistikor të Kosovës duhet të fillojnë studimet e posaçme. Qëllimi është që të gjinden metodat efikase të grumbullimit të të dhënave nga burimet administrative, siç janë regjistrat, dhe bashkëpunimi me agjencionet publike për marrjen e rregullt të të dhënave dhe, kur ka mundësi të ndikohet tek ato për ndërrimin e rutinës me qëllim të mundësimit të grumbullimit të të dhënave për statistikat zyrtare.

### **Ndërtimi i kapaciteteve**

Transferimi i diturisë mbi prodhimin modern të statistikave dhe ndërtimi i kompetencës në ESK paraqet çelësin e sistemit të qëndrueshëm. Do të elaborohet gjerësisht dhe me kujdes disajnimi i planit të zhvillimit të burimit njerëzor. Ky plan do ta përfshijë mbar personelin vendor dhe do t'i siguroj planet zhvillimore individuale. Krahas dijes së re, synohet edhe shtimi i motivimit. Është propozuar një trajnim i posaçëm për të gjithë menaxherët.

### **Koordinimi, organizimi, përgjegjësitë**

ESK do të jetë përgjegjës për të gjitha Statistikat Zyrtare në Kosovë përveç Statistikave Monetare të menaxhuara nga BPK. ESK tash i është bashkangjitur Ministrisë së Shërbimeve publike. Në pajtim me normat e vendosura ndërkombëtare, ESK duhet të jetë agjencion i pavarur publik.

Komiteti Koordinues Statistikor. Rekomandohet një bord këshilldhënës, i kryesuar nga drejtori i ESK me anëtarë nga ministrinë, komunat, OJQ-të dhe sektori privat, për koordinimin e strategjive, metodave dhe prodhimin e Statistikave Zyrtare të Kosovës.

### **Mjete për zbatimin e planit**

Personeli vendor. Duhet të ndërtohet një sistem i qëndrueshëm lidhur me personelin vendor të financuar nga Qeveria. Megjithëse të gjitha ministrinë kanë shprehur interesimin për t'i dhënë përkrahje ESK-së, zgjerimi i propozuar i Entit statistikor është më se modest krahasuar me nevojat e kalkuluara. Në bazë të propozimit, do të shtohet numri i personelit nga 125 (buxheti i vitit 2002) në 155 (buxheti i propozuar për vitin 2005).

Paisjet dhe trajnimet. Ndërtimi i kapacitetit teknik është duke vazhduar dhe shumica e personelit do të ketë qasjen në KP dhe do të kyçet në rrjetë, të gjitha zyrtar rajonale do t'i kenë serverët dhe qasjen në internet. Do të jetë në dispozicion edhe sofveri për të gjitha nevojat statistikore si dhe do të zbatohen programet e trajnimit për personelin.

Konsulentët ndërkombëtar. Transferimi i diturisë tek personeli vendor është i domosdoshëm me qëllim të arritjes së një sistemi të qëndrueshëm. Konsulentët ndërkombëtar do të shfrytëzohen për misionet afat-gjata. (12 e më shumë muaj) në

disa fusha kyçe. Një numër misionesh të shkurta të specialistëve teknik janë poashtu pjesë e rëndësishme e këtij plani.

### **Financimi i donatorëve**

Është propozuar plani tre vjeçar, plotësisht i financuar nga donatorët, në vlerë rreth katër milion Euro. Mund të ndodh një zvogëlim i kësaj shume për shkak të pjesëve që eventualisht do të mbulohen nga projektet aktuale apo të planifikuara. Rekomandohet hulumtimi dhe koordinimi i mëtejshëm i këtyre projekteve.

### **Zbatimi i planit**

Për të siguruar zbatimin e sinqertë të këtij plani zhvillimor, pas përgatitjeve të një procesi përkatës, duhet të merret vendimi përkatës nga Qeveria. Andaj, edhe ndryshimet e këtij plani duhet të kalojnë përmes procesit të njëjtë dhe duhen aprovuar nga Qeveria.

## 2 Historiku dhe parathënia

Duke marrë parasyshë konfliktin në rajon dhe historinë aktuale shihen qartë arsyet përse statistikatat zyrtare nuk i përmbushin standardet e një shoqërie bashkëkohore. Enti Kombëtar i statistikës si i tillë nuk ka ekzistuar para organizimit të ri të filluar në gusht të vitit 1999. Enti i Statistikës i Kosovës (ESK) tani, në ekonominë e tregut, synon të bëhet një Ent bashkëkohor dhe efikas i statistikës. Përshkrimi i shkurtë i veprimtarisë së tanishme është prezentuar në shtojcën (2).

Në Kushtet e Referencës të këtij projekti, shiko shtojcën 1, është theksuar se statistikatat mbi Kosovën janë të shkapërderdhura dhe jo komplete. Burimet vendore janë të kufizuara dhe nuk mundësojnë menaxhimin e këtyre burimeve si dhe mungon strategjia e përgjithshme për zhvillimin e një sistemi bashkëkohor statistikor.

Poashtu, ekziston edhe rreziku i shfrytëzimit jo efikas të burimeve të pakëta nëse përmes koordinimit përkatës nuk evitohen dyfishimet. Koordinimi është poashtu i nevojshëm për sigurimin e krahasueshmërisë përmes shfrytëzimit të metodave, definicioneve dhe klasifikimeve të pranuar.

Synim përfundimtar është ndërtimi i një sistemi gjithpërfshirës dhe të qëndrueshëm statistikor të cilësisë së mirë për Kosovën. Në këtë raport është bërë vlerësimi i nevojave të shoqërisë për informacione dhe ndihmë teknike (ekspertë, trajnime, paisje). Raporti paraqet propozimin e një plani afat-mesëm zhvillimor tre vjeçar. Ky propozim duhet shikuar si periudhë fillestare drejtë krijimit të një sistemi më të kompletuar dhe më të integruar.

Këtë projekt e financoi Banka Botërore. Konsultantët e lartë Borje Dernulf dhe Sten-Ake Hallen, B-J Menagement AB Suedi, e realizuan punën në bashkëpunim me dy konsultantët vendor, Ilir Berisha dhe Halit Kadriu. Puna u realizua në bashkëpunim të ngushtë me ESK. Për këtë projekt janë shfrytëzuar informacionet nga ‘Vlerësimi i Shkurtë i Entit të Statistikës së Kosovës’, Drafti i Eurostat-it i datës 21 Qershor 2002, dokumentet lidhur me projektet e financuara nga Sida ‘Përkrahja e Statistikave Ekonomike dhe TI në Kosovë’ dhe ‘Përkrahja Statistikave të Bujqësisë së Kosovës’, dhe Drafti i Master Planit Strategjik të Entit të Statistikës së Kosovës (i pa publikuar) si dhe Kushtet e Referencës të projektit të ri ASPAU të financuar nga AER (Njësia e Statistikave të Bujqësisë dhe e Këshillave mbi Politikat).

Gjatë periudhës prej 3 -26 shtator 2002 në Kosovë janë realizuar një varg takimesh me përfaqësuesit e ministrive, komunave, OJQ-ve, etj. Poashtu, janë realizuar edhe një varg takimesh me divizionet e ndryshme brenda ESK si dhe me një zyrë rajonale. Shiko, në shtojcën nr. 2, listën e personave dhe organizatave me të cilat janë realizuar takimet. Çështjet kryesore të trajtuara në këto takime ishin: nevojat për informacione, burimet dhe organizimi si dhe çështjet ligjore dhe të koordinimit. Agjenda e këtyre takimeve mund të gjindet në shtojcën nr. 4.

Rezultatet e para si dhe skema e planit zhvillimor u prezentuan në seminarin e organizuar në ESK me datën 26 Shtator 2002. mbi 50 persona morrën pjesë në këtë seminar. Drafti përfundimtar i raportit iu prezentua 25 pjesmarrësve me 23 Tetor ndërsa personelit të ESK me 24 Tetor 2002 .

### 3 Statistikat Zyrtare dhe funksionet e sistemit statistikor

#### 3.1 Roli i informimit

Në shoqërinë demokratike sistemi i informimit përbëhet prej tri pjesëve:

- Debati publik, i mbështetur në qasje të lirë për informacione dhe të drejtën për shprehjen e mendimeve;
- Hulumtimi i lirë me qëllim të prezentimit në debat të argumenteve të kualifikuara;
- Statistikat zyrtare.

Një shoqëri e organizuar mirë i shfrytëzon informacionet për planifikim, monitorim dhe për diskutimin e alternativave në fusha të ndryshme. Është e evidente se entet kombëtare të statistikave janë shumë të rëndësishme nëse mund të sigurojnë informacione të dobishme për marrjen e vendimeve dhe për diskutim të informuar në procesin demokratik.

Në seksionet vijuese janë përshkruar funksionet kryesore dhe definicioni i sistemit të statistikave zyrtare.

#### 3.2. Funksionet kryesore të sistemit informativ statistikor <sup>1</sup>

Një sistem informativ statistikor e përmbush detyrën e vet përmes ushtrimit të këtyre tri funksioneve:

1. Funksioni i sigurimit të inpueteve, i cili në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë e vështron (mat) sistemin e karakteristikave të një objekti dhe i përgatit dhe i ruan informatat e sigururara në formë të dhënash, të ashtuquajtura mikro të dhëna;
2. Funksioni agregues, bënë transformimin e mikro të dhënave, të prodhuara përmes funksionit të sigurimit të inpueteve në formë të mikro të dhënave, apo statistikave, që paraqesin vlerat e vlerësuara të karakteristikave statistikore;
3. Funksioni i dhënies së autpueteve, i cili ua vënë në dispozicion shfrytëzuesëve makro të dhënat, statistikave, dhe u ndihmon shfrytëzuesëve për interpretimin dhe analizimin e mëtejshëm të të dhënave.

Sistemi informativ statistikor ndodhet mu në mes të një sistemi më të gjërë statistikor

të një shoqërie. Në këtë kontekst më të gjërë nga njëra anë i keni shfrytëzuesit e ndryshëm të statistikave të cilët i shprehin nevojat dhe kërkesat e tyre për informacione, marrjen dhe nxjerrjen e ekstrakteve përkatëse për nevojat e tyre të ndryshme. Është shumë me rëndësi të ndërmerren masat për ruajtjen e dialogut ndërmjet shfrytëzuesëve dhe prodhuesëve të statistikave-si për kërkesat ashtu edhe për furnizimin. Për dialog nevojitet njohuria dhe përvoja e të dy palëve mbi statistikave. Ndërsa, nga ana tjetër, i keni siguruesit e të dhënave-individët, amvisëritë, firmat, forumet administrative kombëtare, autoritetet rajonale dhe lokale, etj. Këtu ju duhet të ndërtoni dhe kultivoni besimin-si vlerën më të rëndësishme të statistikave zyrtare krahas ruajtjes së sekretit dhe diskrecionit. Mbi të gjithë ju i keni ‘blerësit’ e statistikave, ndër më të rëndësishmit është qeveria e cila financon furnizimin me statistikave zyrtare themelore, por edhe shfrytëzuesit tjerë që janë të gatshëm t’i paguajnë informacionet e veçanta.

Në Kosovë, ESK ndodhet në fillim të ndërtimit të sistemit statistikor. Nevojitet kohë dhe punë e mirëfilltë për ndërtimin e një sistemi gjithëpërfshirës dhe të



integruar statistikor. Megjithëse ekzistojnë shembuj të mirë në shtete tjera, ku edhe nevojat për informacione janë pak a shumë të njehta, nuk është detyrë e lehtë të importohet një sistem i tërë statistikor dhe të zbatohet në një shtet tjetër. Sistemi bashkëkohor statistikor është mgushtë i lidhur me pjesët tjera të infrastrukturës së shoqërisë. Zhvillimi dhe shfrytëzimi i kanaleve të informimit bëhet paralelisht me zhvillimin e sistemit ligjor dhe administrativ të një vendi.

### 3.3. Statistikat zyrtare

Statistikat zyrtare formojnë një pjesë të rëndësishme të infrastrukturës informative të shoqërisë. Statistikat zyrtare duhet të sigurojnë informacione globale lidhur me situatën dhe trendet zhvillimore. Statistikat e mira zyrtare duhet të japin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të shoqërisë, andaj duhet t'i mbulojnë të gjitha sektoret, aspektet dhe konditat. Statistikat duhet të distribuohen në një formë që mundëson qasje të lehtë dhe formë të kuptueshme në mënyrë që t'i shfrytëzojnë të gjithë të interesuarit në shoqëri.

Në bashkësinë ndërkombëtare, KB i kanë përpiluar rekomandimet përkitazi me statistikat zyrtare dhe statistikat përkatëse të lëmenjëve të ndryshëm. Në Evropë, Enti i Statistikës i BE, Eurostat-i, i jep rekomandimet lidhur me definicionet, klasifikimet dhe standardet. Për shtetet anëtare të BE disa nga këto rekomandime janë të obligueshme. Natyrisht, standardet ndërkombëtare kanë për qëllim mundësimin e krahasueshmërisë ndërmjet shteteve dhe në kohë.

Parimet Fundamentale të KB mbi Statistikat Zyrtare (të aprovuara nga Komisioni Statistikor i KB në vitin 1994) theksojnë:

- Pavarësinë e Entit kombëtar të statistikës për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me punën profesionale statistikore;
- Obligimi për dokumentim dhe raportim të metodave dhe proceseve të zbatuara (transparenca);
- Obligimi për të vepruar kundër keqpërdorimeve dhe keqinterpretimeve; dhe
- Shfrytëzimi i të dhënave të mbledhura ekskluzivisht për qëllime statistikore (fshehtësia absolute e të dhënave).

Statistikat zyrtare duhet t'i përmbushin disa standarde të cilësisë. Standardet janë definuar lidhur me relevancën, mbulimin, objektivitetin, metodat e koordinuara, definicionet dhe klasifikimet, saktësinë, konsistencën, dokumentimin e parimeve dhe vënien në dispozicion. Definicionin operacional të statistikave zyrtare në nivel kombëtar duhet ta sajoi vet kombi përkatës. Pastaj, Qeveria zakonisht e konfirmon përmbajtjen e statistikave zyrtare. Në Kosovë, Enti i Statistikës i Kosovës (ESK) ka për detyrë prodhimin e statistikave zyrtare.

Me rastin e prodhimit të statistikave zyrtare, parakusht për arritjen e statistikave të mira, është bashkëpunimi i mirë ndërmjet agjencionit statistikor, shfrytëzuesëve tjerë dhe dhënësve të të dhënave:

- Qytetari, publiku i gjërë, duhet t'i siguroj të dhënat në nivel individual dhe të ekonomisë shtëpiake, por, njëherit duhet të jetë edhe shfrytëzues i informacioneve mbi shoqërinë;
- Ndërmarrjet duhet t'i japin informacionet mbi bizneset dhe njëherit do t'i shfrytëzojnë informacionet mbi tregun;
- Agjencionet publike, OJQ-të organizatat duhet t'i japin informacione dhe do të mundën t'i shfrytëzojnë statistikat zyrtare për operacionet përkatëse të tyre.

#### **4 Rezultatet e përgjithshme, synimet afat-mesme dhe prioritetet**

##### **Rezultatet**

Gjatë takimeve, lidhur me projektin, është theksuar nevoja urgjente për informacione mbi ekonominë, kushtet e jetesës dhe indikatorët për krahasimin në kohë dhe në mes regjioneve. Më e theksuar është mungesa e të dhënave themelore mbi popullsinë, bizneset dhe shfrytëzimin e pronave/tokave.

Të gjitha ministrinë kanë kërkuar të dhëna më të sakta për fushat e tyre përkatëse për qëllime planifikimi dhe monitorimi. Nevoja të njëjta kanë shprehur edhe komunat dhe OJQ-të. Organizatat donatore kanë një interes evident për indikatorët e realizimit. Poashtu, sektori privat kërkon më shumë të dhëna të sakta. Krahasimi i nevojave statistikore dhe i autputeve në vendet tjera, poashtu, dëshmon një mungesë të konsiderueshme të informatave.

Kur mungojnë statistikat zyrtare zgjidhja e problemit të informacioneve bëhet përmes anketave ad-hok në bazë të kornizave të përkohshme të mostrës. Një varg prodhuesish i relizojnë anketat; institutet private, ministrinë, OJQ-të, etj. Thënë përgjithsisht, nuk ka koordinim në mes të prodhuesëve lidhur me metodat, standardet apo prodhimin. Cilësia është e pasigurt. Nuk ekziston baza e të dhënave mbi statistikat e prodhuara, andaj, është vështirë të realizohet qasja të dhënave.

Si përfundim, mund të thuhet se në të gjitha fushat është e theksuar nevoja për më shumë të dhëna dhe statistika zyrtare. Këto nevoja shtrojnë nevojën e fuqishme për zhvillimin e një sistemi të ri të aftë për përmbushjen e kontekstit dhe kërkesave të reja të demokracisë dhe ekonomisë së tregut.

Ekziston vetëdija e përgjithshme mbi standardet, definicionet dhe klasifikimet e zbatuara në botë si dhe vullneti unanim për harmonizim me rregulloret e BE në këtë fushë. Këto kërkesa, momentalisht, nuk mund të plotësohen pa ndihmën e ekspertëve ndërkombëtar.

ESK ekziston, në formën e tanishme, vetëm pakë vjet dhe deri më tani nuk ka qenë në gjendje të publikoj statistika në të gjitha fushat. Dukshmëria në shoqëri ka qenë më se e ulët. Tani është duke u realizuar një përparim i konsiderueshëm dhe Enti është duke u përpjekur shumë që me prezentimin e të dhënave t'i mbuloj mungesat e informacioneve. Veb-sajti i ESK shënon një fillim të mbarë për realizimin e synimit për t'u shndërruar në portë të statistikave të Kosovës. Problem në vete për ESK, si dhe për shumicën e agjencioneve publike në Kosovë, paraqesin rrogat shumë të ulëta. Ky fakt e rrezikon

synimin për të siguruar personel të motivuar që do t'i kushtonin vëmendje të plotë statistikave dhe për ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm përmes trajnimeve dhe zhvillimit permanent.

##### **Synimet afat-mesme**

Ndërtimi i sistemit gjithëpërfshirës dhe të integruar të statistikave zyrtare kërkon kohë të konsiderueshme. Në përputhje me një periudhë tre-vjeçare, duhet të formulohen objektivat përkatëse. Ky plan zhvillimor, pas tre vjetësh, i synon këto rezultate:

- Publikimin e të dhënave themelore mbi popullsinë

- Publikimin e rregullt të statistikave për të gjitha sektoret e rëndësishme të bizneseve
- Prodhimin dhe publikimin e llogarive kombëtare
- Anketat e rregullta të bujqësisë
- Publikim e rregullt të statistikave të faktorëve të rëndësishëm social
- Njohjen dhe shfrytëzimin e statistikave zyrtare për vendim-marrje dhe diskutim publik
- ESK të bëhet organizatë funksionale me kushte të mira të punës
- ESK të ketë raporte të mira pune me shfrytëzuesit dhe prodhuesit në Kosovë dhe në botë
- ESK të ketë aftësi për zhvillimin e sistemeve të informimit dhe të statistikave në fusha të reja.

### **Prioritetet**

Plani synon që, fillimi i ndërtimit të një sistemi statistikor gjithpërfshirës dhe të qëndrueshëm, të bëhet në këto tri drejtime kryesore: 1) të mbledhen më shumë të dhëna dhe të publikohen më shumë statistika, 2) të ndërtohet kapaciteti në mënyrë sistematike, dhe 3) të koordinohen prodhimi, metodat dhe standardet.

### ***Prodhimi i statistikave***

Ka për qëllim mbledhjen e më shumë të dhënave, publikimin e më shumë statistikave dhe shtimin e cilësisë me kohë. Shumica e sistemeve kombëtare statistikore janë ndërtuar mbi këto tri komplete të të dhënave themelore: të popullsisë, bizneseve dhe pronës/tokës. Këto komplete të të dhënave janë të pavarura dhe të gjitha i nevojiten sitemit. Andaj, aktivitetet paralele janë të paevitueshme. Plani e sqaron orientimin në vija të trasha. Plani më i hollësishëm duhet të elaborohet në një fazë më të vonshme.

Poashtu, janë propozuar edhe studimet e mëtejme të shfrytëzimit të të dhënave administrative dhe duhet të krijohen projektet ndërmministrore për hartimin e planit zhvillimor afat-gjatë të këtij sistemi.

### ***Ndërtimi i kapacitetit***

Qëllimi është që të ndërtohet kapaciteti i fuqisë punëtore/knoë-hoë dhe paisjeve me perspektivë të gjatë për shfrytëzuesit dhe prodhuesit. Duhet të lansohet Programi i Zhvillimit të Burimeve Njerëzore për realizimin e këtij synimi. Konsultantët me qëndrim të gjatë në të gjitha divizionet do të ndihmojnë për transferimin e dijes knoë-hoë, mbi metodat dhe sistemet statistikore, personelit të ESK. Poashtu, do të realizohen edhe misionet e kohë paskohshme afat-shkurta të ekspertëve ndërkombëtar.

Meaxhimi i ESK dhe i procesit zhvillimor janë faktorët kyç të mbarë programit. Planifikimi dhe monitorimi i Programit të Burimeve Njerëzore kërkon kujdes të veçantë menaxhues dhe nevojitet forcimi i përkohshëm i burimeve menaxhuese.

## **Koordinimi**

Ka për qëllim zhvillimin e sistemit efikas kombëtar me përgjegjësi të qarta të prodhuesëve ku shfrytëzohen definicionet dhe standardet ndërkombëtare dhe ku sistemet prodhuese bëhen me kohë më të integruara dhe më konsistente. Për arritjen e këtij synimi janë propozuar aranzhmane të caktuara të koordinimit dhe bashkëpunimit. Burimet e pakëta të burimeve statistikore në Kosovë duhet të përqëndrohen në ESK.

### **5 Prodhimi Statistikor. Projektet/aktivitetet e propozuara**

#### **5.1 Renditja**

Kjo kaptinë përmbanë propozimet lidhur me vijën e parë të zhvillimit të statistikave në Kosovë-ndërtimin dhe zgjerimin e prodhimit statistikor që ka të bëjë me përmbajtjen statistikore dhe, deri diku, me metodat e prodhimit. Organizimi ekzistues i ESK, me katër divizione përkatëse, është shfrytëzuar për këtë kaptinë. Për këto katër pjesë, në hyrje jepet përshkrimi dhe vlerësimi i shkurtër i gjendjes aktuale, të shoqëruar me propozimet e formuluar siç janë projektet/aktivitetet e rekomanduara. Propozimet janë përmbledhur në kaptinë 8, tabela 3, ku poashtu mund t'i gjeni sygjerimet mbi prioritetet për secilin projekt bashke me orarin dhe ndihmesën teknike përmes konsulentëve afat-gjatë dhe afat-shkurtër.

Lista e projekteve mund të duket masive apo tepër ambicioze. Këtij pohimi mund t'i përgjigjemi me faktin se ekzistojnë nevoja urgjente për informacione dhe se qysh tani një prodhim përkatës është duke u realizuar e disa posa kanë filluar-dhe meqenëse janë të rëndësishëm duhet të përfshihen në këtë plan, ndërsa indikatorët e prioritetëve dhe afati kohor nënkupton shpërndarjen gjatë tre vjetëve, madje disa projekte/aktivitete as që do të përfundojnë brenda afatit të planifikuar. Krahasoni këto edhe me objektivat afat-mesme ashtu siç janë prezentuar në kaptinë 4.

#### **5.2 Statistikat e popullsisë**

##### **Parathënia**

Me çdo kend që bisedoni mbi statistikën në Kosovë, çështja e të dhënave themelore mbi popullsinë theksohet si prioriteti më i lartë në agjendë. Kjo çështje është me interes për të gjithë, prej komunave, të cilat kanë urgjentisht nevojë për të dhënat që do t'u shërbenin si bazë për planifikimin dhe udhëheqjen e shërbimeve lokale, deri te ekonomistët të cilëve u mungojnë të dhënat për kalkulimin e të hyrave për kokë banori dhe kalkulimin e prodhimit.

Regjistrimi i fundit i popullsisë dhe i banesave, i njohur nga shumica e popullsisë, është realizuar në vitin 1981. Është realizuar edhe një regjistrim në vitin 1991 në të cilin shumica e shqiptarëve të Kosovës nuk mori pjesë. Për shkak të konfliktit, kanë ndodhur shumë ndryshime dhe lëvizje të mëdha të popullsisë, p.sh. shumë indikacione shpiejnë në konkludim se është duke u zhvilluar një urbanizim rapid. Madje edhe vlerësimet mbi numrin e përgjithshëm të popullsisë dallojnë shumë-nga 1.8-2.4 milion banorë, varësisht se çka nënkuptohet me formulimin "popullsia e Kosovës". Popullsia rezidente zakonisht vlerësohet se është 1,8 deri 2.0 milion.

Sistemi i statistikave vitale për lindjet, vdekjet dhe martesat ka rifilluar në muajin Gusht të vitit 2001 dhe raportet e para do të publikohen në këtë vjeshtë. Sipas personelit të ESK, ka probleme me mbulim të pamjaftueshëm, në veçanti përkitazi

me regjistrimin e vdekjeve. Formularët e regjistrimit e kanë hapsirën e paraparë për të dhënat për shkakun e vdekjes, e që do të siguroj statistika të çmueshme. Fatkeqësisht, këto të dhëna mungojnë në shumicën e rasteve, për shkak të mungesës evidente të personelit kompetent në spitale.

Që nga viti 1989 nuk ka pasur regjistrim, andaj nuk ka as statistika mbi migracionin e brendshëm. Sot, janë mbledhur disa informacione nga Anketat e Fuqisë Punëtore, por, natyrisht, ato mund t'i sigurojnë vetëm indikacionet e përafërta mbi trendin e migracionit. Duket se në të ardhmen kjo çështje duhet të trajtohet për të gjetur zgjidhje adekuate.

Duke u mbështetur në regjistrimin civil, UNMIK-u e ka krijuar regjistrin administrativ të popullsisë-përfshirë numrin identifikues-i cili p.sh. shërben për regjistrat elektorale dhe për letërnjoftime. Regjistri i përfshinë 1.268.000 banorë mbi moshën 16 vjeç. Deri më tani nuk është diskutuar mundësia që ky regjistër, si dhe burimet tjera administrative, të shërbejnë si bazë për krijimin e një baze statistikore mbi popullsinë.

### **Projektet/aktivitetet e propozuara**

#### ***P1: Regjistrimi i Popullsisë dhe i Banesave***

Nevoja për një regjistrim në Kosovë, sa më parë që është e mundur, është e vetëkuptueshme. Këtë mendim e kanë shprehur të gjitha palët-si brenda departamenteve të UNMIK-ut ashtu edhe në ministritë dhe organet tjera. Nuk kishte ngurim lidhur me çështjen e “arsyeve politike” përkitazi me minoritetet brenda popullsisë. Mendimi i përgjithshëm lidhur me këtë çështje mund të citohet si vijon: “për të gjithë ne është shumë më mirë ta dijme situatën, se sa të jemi të shtrënguar t'i vazhdojmë spekulimet dhe diskutimet se si është përafërsisht situata”.

Regjistrimi i ardhshëm duhet t'i synoj tri objektiva, të cilat duhet të parashikohen me rregullore të veçantë mbi regjistrimin:

- Statistikat themelore dhe të rregullta për individë- për moshën, gjininë, statusin martesor, nënshitetësinë, arsimimin, punësimin ( dega, vendi I punës, profesioni, orët e punës), të ardhurat, mbi përmëbrjen e ekonomisë shtëpiake dhe njësitë e tyre/ sipërfaqen e apartamenteve, paisjet, ngrohja, pronësia.
- Korniza të mostrave për anketat e ardhëshme të drejtuara nga individët, ekonomitë shtëpiake ose njësitë e ekonomive shtëpiake.
- Për të caktuar platëformën dhe pikënisjen për përpilimin e regjistrimit të statistikave popullsisë si dhe të statistikave mbi ndryshimet aktuale të popullsisë – nëse vihet në përfundim se një projekt i veçantë mbi kjo çështje do të mundësoj arritjen e rezultateve përkatëse.

Regjistrimi i popullsisë duhet të sigurojë statistika për divizione rajonale – për 30 komuna por gjithashtu edhe përrreth 1400 qarqe statistikore , të cilat japin të dhëna për fshatra dhe pjesë të qyteteve të mëdha.

Pasi që bujqësia luan një rol dominues në ekonominë e Kosovës është diskutuar së regjistrimi i popullsisë dhe ekonomive shtëpiake duhet të përqendrohet në te dhe të shiqohet për bazat e regjistrimit të ardhshëm bujqësor. Kjo është mjaft e arsyeshme në njërin anë , në anën tjetër kjo ambicie duhet të vlerësohet përkundër qëllimeve për të realizuar një regjistrim më të thjeshtë dhe të drejtëpërdrejtë- sa i përket ngarkesës, detyrimeve buxhetore dhe- më e rëndësishmja- njevoja urgjente për të dalur me rezultate mundësisht sa më shpejtë.

Propozimet dhe plandat initiale janë për të filluar regjistrimin në fund të muajit Mars 2004; vlerësimi i kostos totale është 6.5 Euro. Këto propozime ne i kemi paraqitur në Prill të këtij viti, dy vjet më herët për planifikim dhe përgaditje të detajizuara-zakonisht afati kohor i nevojshëm sipas përfojës në përgjithësi. Pra, definitivisht është koha për të marrur konkluzione dhe vendime. Duhet përgjigjur disa pyetjeve; a është ende e mundur të realizohet regjistrimi në Mars 2004? Nëse jo, cila është alternativa tjetër ndërkohë? Çfarë faktesh dhe vlerësimesh janë të nevojshme për një vendim? A ka ndonjë proces të prerë qartë për marrjen e vendimit të regjistrimit? Vendimi politik për të realizuar një regjistrim është nevojë urgjente e cila ndikon në të gjitha fushat e tjera statistikore.

Gjatë këtij projekti, nuk ka pasur mundësi të shkojmë të tutje dhe më thellë me qështje të regjistrimit të popullsisë- për shkak të prioriteteve kryesore. Kjo dmth që regjistrimi i Kosovës duhet t'iu shtohet propozimeve- në aspektin e planifikimeve, kuadros, nevojave për paisje, ndihmës teknike dhe financimit. Besohet që donatorët ndërkombëtare kanë qëndrim pozitiv ndaj regjistrimit dhe do të sigurojnë fonde për te.

## **P2: Projekti mbi sistemin e statistikave aktuale vitale**

Faza e parë e këtij pojekti do të jetë studimi dhe vlerësimi i mundësive aktuale dhe të ardhshme që mund të rezultojnë me statistika vjetore të popullsisë – të dhënat mbi materialin dhe ndryshimet. Pyetjet kryesore mbi këtë studim janë:

- Si ta përmisojmë kualitetin e të dhënave të lindjeve dhe vdekjeve?
- Si mund të krijohen të dhënat mbi migrimin e brendshëm dhe të jashtëm?
- Çka është e nevojshme për të ndërtuar regjistrin e popullsisë, duke filluar me regjistrin aktual administrativ?
- A mund të kombinohen këto tri burime në një sistem funksional?

Qëllimi i këtij studimi duket ambicioz por është më mirë të filloj në nivel të lartë kur bëni përshkrimin e nevojave dhe mundësive. Kur dhe nëse pengesat dhe problemet zbulohen, qëllimet për fazën e ardhshme të projektit duhet të modifikohen. Për shembull; nëse bëhet e qartë se për themelimin e të dhënave të migrimit duhet vite, atëherë përqendrohuni në grumbullimin e të dhënave përmes regjistrit të popullsisë.

Ky projekt duhet të koordinohet me hulumtimet dhe planet për regjistrimin e popullsisë, pasi që interesat dhe mundësitë janë të shumta në mes dy veprimtarive. Është e qartë lidhja që regjistrimi i popullsisë mund të rezultojë fillimin e regjistrit të popullsisë.

## **P3: Statistikat Gjinore**

Në fillimi të vitit 2000 ESK dhe UNIFEM-i kanë realizuar projektin “ Pozita ekonomike e gruas kosovare dhe mundësitë e saj për punësim”. Studimi është bazuar në një mostër të vogël, por gjithashtu mund të shiqohet edhe si fillim i statistikave gjinore në Kosovë edhe nëse ka të bëjë vetëm me njërën prej gjinive. Sot mundësitë për të raportuar gjendjen për meshkuj dhe femra janë më të mira duke shfrytëzuar të dhënat nga anketat e ndryshme të realizuara dhe nga statistikatat e arsimit psh. Gjithashtu janë mundësitë për të gjetur inspirimin nga jashtë (diaspora), pasi që shumica e zyrtarëve statistikore, KM dhe OJQ-të kanë zhvilluar statistikatat gjinore.

Projekti për statistika gjinore kapërthen kryesisht përpjekjet për grumbullimin, analizat dhe publikimin e të dhënave.

## 5.2 Statistikat ekonomike

### Hyrje

Përmirësimi i statistikave ekonomike është një nevojë urgjente. Disa parti kanë paraqitur këtë nevojë me detaje të shkallëve të ndryshme. Kërkesat gjithashtu mund të gjinden edhe në udhëzimet ndërkombëtare dhe nga përvoja e vendeve tjera.

Në këtë fushë një projekt bukur i madh është në vazhdim dhe tjetri projekt pritet të fillojë. Projekti i tretë i madh që ka të bëjë me bujqësinë gjithashtu është i rëndësishëm në këtë kontekst.

Projekti në vazhdimësi është realizuar nga Statistikat e Suedisë, i financuar nga Sida dhe ka dy qëllime kryesore:

Për të zhvilluar fushat e caktuara statistikore, p.sh. Regjistrin e subjekteve afariste, të dhëna për llogari kombëtare, statistikat afat-shkurtëra dhe vjetore, statistikat e çmimeve, statistikat e tregtisë së jashtme, realizimi i serive kohore dhe i mundësive për analizat ekonomike;

Të siguroj marrjen e vendimeve duke u bazuar në të dhënat përkatëse dhe të besueshme të cilat i plotësojnë kërkesat e vendit (të brendshme) dhe i përgjigjen kërkesave të UE. Anketat e Buxhetit Familjar formojnë një pjesë të rëndësishme të projektit. (Për Anketat Familjare shiqo në sektorin e Statistikave sociale).

Projekti i dytë financohet nga EU dhe është pjesë e programit të AER. Detajet e projektit ende nuk janë paraqitur publikisht përderisa procesi ofertues është në vijim. Qëllimi kryesor me siguri do të jetë ndërtimi i kapacitetit të ESK-së në grumbullimi e llogarive themelore gjithëpërfshirëse kombëtare dhe llogarive tjera.

Projekti i tretë i financuar nga AER, ka të bëjë me anketat bujqësore dhe ka ndikim kryesor në statistikat ekonomike. (Për statistika të bujqësisë shiqo sektorin e statistikave të Bujqësisë).

Në planin zhvillimor, fusha ekonomike është konsideruar njëra ndër më të rëndësishmet. Pjesa më e madhe është caktuar për statistikat ekonomike dhe janë propozuar një numër i madh i projekteve në fushën ekonomike. Disa nga këto aktivitete janë përshkruar shkurtimisht në seksionet në vijim. Megjithatë harta e detajzuar e punës për vitin e ardhshëm nuk është prezantuar. Janë disa parti aktive, donatorë dhe prodhues, të cilët janë të përfshirë në zhvillimin e statistikave. Mes tyre duhet të arrihet një konsensus mbi mënyrën e zhvillimit. Do të ketë rëndësi vendimtare për të koordinuar planifikimin e projekteve të ndryshme për të arritur një proces efikas të zhvillimit në ESK. Përkrahja e shoqërisë së bizneseve të Kosovës, gjithashtu është e nevojshme për të patur sukses.

### Projektet / Veprimtaritë e Propozuara

#### E1: Kordimi i projektit me statistikat ekonomike

Prioriteti i lartë i është dhënë vazhdimësisë së ndërtimit të kapacitetit në ESK, për të realizuar statistikat ekonomike. Është esenciale që të bashkohen forcat për të siguruar një proces efikas. Rolet kryesore do të kenë ESK, Autoriteti Qëndror Fiskal (AQF), Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), BPK, Sida dhe AER.

ESK është përgjegjës për statistikat zyrtare në këtë fushë. Sot kapaciteti i ESK nuk është i mjaftueshëm të realizoj dhe publikoj të gjitha informacionet e nevojshme. Veprimtaritë në vijim ose të planifikuara kanë për qëllim ndërtimin e kapacitetit në ESK. ESK në të ardhmen do të ketë rolin udhëheqës në fushën e statistikave ekonomike.

AQF/MFE sot luajnë rol të rëndësishëm dhe udhëheqës në fushën ekonomike duke ju falendëruar rezultateve të treguara në statistikat ekonomike. AQF/MFE demonstroi kompetenca të larta dhe eksperiencë të mira në terren dhe vlerësime të llogaritura në

bazë të burimeve të ndryshme dhe në burime të përkohshme dhe publikon statistika të rregullta. AQF/MFE kërkon të dhëna më të mira për vlerësime makro ekonomike. Për llogaritë kombëtare në të ardhmen duhet të përmirësohen të dhënat përkatëse. Në ndërtimin e kapacitetit të ESK-së rekomandohet bashkëpunim i ngushtë mes ESK-së dhe AQF. Në këtë proces duhen të shfrytëzohen përvojat e AQF/MFE. Në afatë të gjatë kohorë ESK do të realizoj Llogaritë Kombëtare. Ky realizim duhet të bëhet në kontakt me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, të cilët janë edhe shfrytëzuesit më të rëndësishëm.

Sida, përmes Statistikave të Suedisë përkrahin ESK përmes projektit në vijim "Përkrahja e statistikave ekonomike dhe TI në Kosovë". Disa pjesë tanimë janë realizuar dhe të tjerat janë në vijim. Pjesët e planifikuara nga ky projekt si dhe të planifikuara nga projekti i AER duhen të koordinohen me veprimtaritë e ndërtimit të kompetencave në përgjithësi të ESK-së.

Është propozuar një projekt special i udhëhequr nga ESK dhe me pjesëmarrësit nga AQF, MFE, Doganave, BPK dhe Fakultetit Ekonomik i Univeritetit të Prishtinës. Qëllimi i projektit do të jetë:

- Të koordinoj planet për t'iu shmangur ngarkesës (bllokimit)
- Të bien dakord për përgjegjësitë
- Të vendosin mbi prioritetet duke marrë parasysh zhvillimin e mëtutjeshëm.

Projekti gjithashtu mund të përshijë organizimin e ngarkesës së punëve që ti zgjedhi urgjent çështjet praktike të bashkëpunimit dhe realizimit.

## **E2: Vazhdimësia e trajnimit në Llogari Kombëtare në ESK dhe zhvillimi i rutinave**

Sistemi i Llogarive Kombëtare mund të shikohet si koordinimi i sistemit të statistikave ekonomike. Ky sistem gjithashtu siguron kornizën e punës dhe një sistem për ta kuptuar ekonominë. Nëse njësitë raportuese për të dhënat e llogarive kombëtare, po ta njihnin sistemin ata do të ishin raportuesit më të mirë të të dhënave me kualitet të mirë.

Është propozuar projekti për përmirësimin dhe realizimin e trajnimit për kuadrin e ESK-së, e veçanërisht në divizionin e statistikave Ekonomike, në Llogari Kombëtare dhe zhvillimin e rutinave për grumbullimin dhe gjenerimin (prodhimin) e të dhënave. Trajnimi mund të organizohet si ligjërata interne, i kombinuar me ushtrime praktike që kanë të bëjnë me kategori të ndryshme të përfshira edhe me zhvillimin e rutinave praktike për realizimin e Llogarive Kombëtare.

Studimet interne duhen të plotësohen me pjesëmarrjen në kurse eksterne dhe me udhëtime studimi në agjencione tjera të statistikave kombëtare. Divizioni i statistikave ekonomike duhet të ketë mundësinë të zgjedh dy punëtorë të Enitit të statistikës me reputacion të mirë që të punojnë jashtë vendit si stazhierë.

## **E3: Përmirësimi i kornizës së mostrave për anketat e Biznesit dhe zhvillimi i programit për sektorin e anketave**

Anketat e biznesit janë burime të rëndësishme për statistikën e pjeseve të ndryshme të ekonomisë. Ato tregojnë gjendjen dhe trendet për sektorët e ndryshme dhe shërbejnë si të dhëna për llogaritë kombëtare. Kualiteti i këtyre anketave varet shumë nga korniza e mostrës, gjegjësisht nga regjistri i biznesit. Regjistri i bizneseve në Kosovë aktualisht nuk është i kompletuar. Veprimtaritë e përkohshme janë rekomanduar për të siguruar një regjistër të kualitetit të mirë për ta shfrytëzuar për qëllime statistikore. Në Kosovë është vështirë për të pasur mbulesë të mirë madje edhe për biznese të vogla.

Është rekomanduar projekti për dizajnimin e mostrave të anketave sipas sektorëve të ndryshëm të bizneseve. Duhet marrë parasysh dallimet e mbulesave të sektoreve të ndryshëm të bizneseve në regjistër dhe të gjinden mjete për ta mbuluar këtë mangësi. Ky projekt duhet të sygjeroj një plan shumë-vjeçar nga i cili janë të hulumtuar të gjithë sektorët e rëndësishëm. Shiqo gjithashtu projektin E4.



Në të ardhmen gjendja duhet të ndryshojë tani kur regjistri administrues i biznesit është riorganizuar dhe të gjitha ndërmarrjet duhet të regjistrohen prapë. Kur të përfundoj ndërtimi i regjistrat administrativ dhe rutina e punës së rregullt të azhurimit, atëherë ESK do të pranojë nga një kopje të regjistrat administrativ. Duhet të arrihet marrëveshja mbi formatin dhe frekuencën.

#### **E4: Programi për anketa të rregullta të Biznesit për sektore të ndryshme**

Nga shumica e sektoreve nevojiten shumë të dhëna. Prandaj janë propozuar projekte ose hulumtime të veçanta. Në sektorin e transportit mungon transporti privat i mallrave dhe njerëzve. Në tregtinë me pakicë dhe shumicë është kërkuar një projekt mbi sektorin privat. Sektoret tjera të cilat duhet të ndriqohen janë industria duke përfshirë energjinë elektrike, ndërtimtarinë, turizmin, hotelet dhe resoronet, dhe sektori i shërbimeve me shërbimet private dhe sociale dhe arsimit në sektorin privat.

Për fillim duhet të realizohen anketat fillestare për secilin sektor. Më vonë këto anketa mund të kalojnë në sistem me anketa të rregullta dhe sistem qarkullues, që do të thotë secili sektor në kohë të caktuar do të ketë hulumtime. Duhet të ndërtohet programi për grumbullimin sistematik dhe të rregullt të të dhënave dhe publikimin e tyre nga sektoret e ndryshme.

#### **E5: Puna e vazhdueshme në Indeksat e Çmimeve dhe Tregti të Jashtme**

##### **Indeksat e Çmimeve**

Projekti i ESK-së në bashkëpunim me Statistikat e Suedisë synojnë lansimin e IÇK, Indeksat e Çmimeve të Konsumit dhe Indeksat e Çmimeve të Importuara. Nga takimet gjatë misionit shihet qartë se përvojat nga projektet dhe kërkesat e shfrytëzuesve do të përkrahin vazhdimësinë dhe shtrirjen e projektit. Projekti i indeksave të çmimeve duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe përfshinë bazë më të gjërë në grumbullimin e të dhënave nga ana e konsumit, importit dhe pordhimit.

##### **Tregtia e jashtme**

Përmirësimet në sistemin statistikor janë arritur duke iu falënderuar bashkëpunimit të mirë me autoritetet doganore. Përmirësimet e mëtuqjeshme mund dhe duhet të bëhen. Është propozuar indeksi i veçantë i çmimeve i bazuar në të dhënat e tregtisë së jashtme dhe mund të realizohet nga të dhënat eksistuese. Kur vie deri të besueshmëria ende ka pyetje rreth mbulesës së tregtisë importuese dhe eksportuese të regjistruara në dosjet doganore. Projekti i ESK duhet të vazhdojë. Drejtimi i projektit në të ardhmen duhet të diskutohet në bashkëpunim me projektin e statistikave ekonomike.

#### **5.4 Hyrje**

##### **Bujqësi**

Më 1990, bujqësia, pylltaria dhe përpunimi i ushqimit është llogaritur si një e treta e BPV të Kosovës. Gjatë viteve 1999-2000 prodhimi ka rënë për gjysmë. Tani, vlerësohet se dy të tretat e popullsisë jetojnë në mjedise rurale dhe varen nga bujqësia ose degët që kanë të bëjnë me rifillimin e këtyre veprimtarive që është interes vital dhe ka nevojë urgjente për informacione udhëzuese dhe përkrahje në zhvillim.

Prodhimi i statistikave të bujqësisë ka rifilluar gjatë vitit 2001 me dy anketa në pranverë dhe vjeshtë. Mostra ka përmbajtur 1.440 ekonomi bujqësore shtëpiake dhe anketa synon në dhënien e statistikave kryesisht në sipërfaqet e mbjellura, bagëti dhe korrije. Gjatë vitit 2002 mostra është rritur në 3.200 ekonomi shtëpiake dhe janë realizuar dy anketa. Deri më tani nuk ka qenë i mundur grumbullimi i të dhënave nga fermat pronësi publike ose kooperativa të cilat më herët janë quajtur ndërmarrje shoqërore (NSH) të kultivojnë rreth 30 % të tokës së punueshme.

Këto arritje janë realizuar në bashkëpunim në mes të ESK-së dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MAPZHR), të cilat kanë njësi të statistikave, analiza dhe krijues të politikave. Ata janë të përkrahur nga Sida-projekt i

financuar për ndërtimin e kapacitetit përmes trajnimeve si psh. në mostra, grumbullim të të dhënave, analiza dhe publikim. Paisjet për TI janë blerë për ESK dhe MBPZHR. Ky projekt është planifikuar të zgjasë 4 vite, 2001-2004.

Projekti i dytë në fushën e bujqësisë ka filluar rishtas. Financohet nga AER, planifikohet të zgjasë dy vite dhe ka akronimin NKPSRB-Njësia Këshilluese për Politikë dhe Statistika Bujqësore. Sipas termeve të referencave MBPZHR është kryesore, ESK pjesën dytësore "... që do të jetë e përkrahur në të gjitha aspektet për zhvillimin e statistikave bujqësore." Edhe pjesa statistikore e këtij projekti ka një sfushë shumë të gjërë veprimi; nga hulumtimet për nevojat e shfrytëzuesve, trajnimin e punëtorëve duke përfshirë rrjetin e anketuesve rajonal dhe zgjedhjen e metodave statistikore, gjer në realizimin e anketës mbi prodhimin bujqësor dhe të strukturës së tokës duke përfunduar me dizajnimin e bazës së të dhënave dhe ndërmarrjen e pilot regjistrimit bujqësor dhe Rrjetin për Llogaritje të të Dhënave mbi Fermat (FADN).

Nevoja e madhe këtu është e dukshme për koordinim dhe bashkëpunim në mes këtyre dy projekteve në njërin anë dhe në mestë projekteve të punës së planifikuar dhe asaj në vijim, në anën tjetër. Kjo gjithashtu parashikon në ToR të projektit ASPAU, forumet e lartëpërmendura siç janë komisioni drejtues, komisioni i përhershëm i statistikave bujqësore dhe grupi punues i specializuar.

Një çështje tjetër kritike mund të jetë i ashtuquajturit kapacitet absorbues në ESK dhe përfundimisht edhe nga punëtorët e MBPZHR, ku inputet dhe ndikimi i këshilltarëve do të jetë shumë i madhe viteve të ardhshme. Punësimi dhe stërvitja e punëtorëve vendor do të bëhet rëndësia më e madhe në ndërtimin përkrahës.

Sa i përket realizimit të statistikave, ESK dhe MBPZHR kanë bashkëpunim funksionues dhe koncensus të përgjishëm rreth nevojave dhe mënyrave për zhvillim të mëtutjeeshëm. Por disa diskutime janë duke u bërë rreth çështjeve të principeve – ndoshta edhe praktike, ku nuk është arritur koncesuesin:

- Në divizionin për përgjegjësi, iniciativë dhe punësim sa i përket statistikave dhe anketave bujqësore. MBPZHR argumentoj se ata duhet për shembull ta kenë mundësinë për vendojsjen dhe realizimin e anketave ad hok si bazë për krijuesit e politikave.
- Zgjedhja metodologjike e kornizës së mostrës dhe teknikave për hulumtimet në të ardhmen.
- Organizimi për grumbullimin e të dhënave: A duhen të ketë anketues të veçantë për anketa të bujqësisë ose ju mund të mbështeteni në zyrat rajonale të ESK-së?

### **Regjistri mbi pronësinë/kadastër**

Agjencioni i Kadastrës së Kosovës (AKK) në vitin e fundit ka ndërtuar një sistem modern të regjistrimit për pronësi i cili përmbanë diku 25 milion parcela dhe 360 000 shtëpi. Në fund të këtij viti platforma teknike do të bartet në SQL. Problemi është mungesa e të dhënave në një numër të madh të mjeteve transportuese gjatë 90-ave, të njohura mirë nga popullsia lokale por jo të regjistruara. Një problem ispecifik dhe ende i ashpër është mungesa totale e librave të kadastrës për fshatrat me shumicën serbe. Nëse kjo punë mund të zgjidhet dhe nëse legjislacioni mbi regjistrimin hyn në fuqi, është vlerësim i AKK-së që regjistri mund të funksionoj me një mbulesë të mjaftueshme dhe kualitet pas dy vite të punës.

Regjistri i pronësive ka rëndësi të madhe gjithashtu për sistemin e ardhshëm statistikor, numri i integriteteve potenciale dhe aplikimeve mund të mendohet për –regjister si kornizë të mostrës, si bazë për statistika të shfrytëzimit të tokës, pronësisë etj. dhe si “emërtim i zakonshëm” për lidhjen e objekteve se ku gjenden përmes emërtimit të duhur dhe kodimit sipas koordinatave. Prandaj është rekomanduar që ky subjekt të shikohet më thellësisht, veçanërisht në kontekst për planifikimin e regjistrimit/anketave të popullsisë, banesave dhe të bujqësisë.

## **Ambienti**

Gjatë takimeve, ndërmjet këtij projekti dhe interesave të tjerë, çështjet e ambientit nuk janë elaboruar si prioritete kryesore. Kjo është e natyrshme në kushtet ekzistuese ku së pari vijnë shumica e kërkesave elementare të mirëqenjes –si siguria, punësimi, të ardhurat,pensionet dhe kujdesi shëndetësor. Akoma janë të dukshme problemet e ambientit në Kosovë, popullata e madhe në disa rajone, në ajr, tokë dhe ujë. Është e pakapshme për këtë projekt nëse ndonjë departamenti, OJQ të tjerë janë duke realizuar këtë punë në terren për të bërë vlerësimin, grumbullimin dhe prezantimin e të dhënave mbi gjendjen dhe ndryshimet në ambient. Prandaj janë rekomanduar angazhime tjera.

## **Ndryshimet e vendbanimeve**

Renovimi, restaurimi dhe veprimtaritë ndërtuese janë të shumta në Kosovë. Kjo duhet planifikuar dhe monitoruar nga autoritetet lokale, por rëndësi të madhe kanë implikimet për sigurimin e strehimeve të popullsisë. Duket e deomosdoshme mbërthimi i kualitetit dhe kuantitetit në këtë zhvillim.

## **Projektet/Veprimtaritë e propozuara**

### **A1: Koordinimi i Statistikave të Bujqësisë**

Është parashikuar koordinimi mes projekteve në vijim të financuar nga Sida dhe projektit të ri të financuar nga AER. Gjithashtu është e dëshirueshme të arrihet marrëveshja së paku e përkohëshme mes ESK-së dhe MBPZHR që ka të bëjë me përgjegjësitë, detyrat dhe metodat – një modus vivendi për vitet e ardhshme.Por së pari me kujdes duhet planifikuar zhvillimin dhe realizimin e statistikave të bujqësisë. Kjo veprimtari synon në ngritjen e kapacitetit të ESK dhe kompetencave për të kryer këto detyra.

### **A2: Anketat e bujqësisë**

Anketat e realizuara duhet të vlerësohen , duhet të bëhet lansimi i programit të ri, të vëhet në realizim dhe shumë angazhime dhe trajnime duhet të caktohen sipas metodave , pastaj në analiza dhe të raportohet. Programi i ri duhet të përfshijë edhe një varg shtesë të anketave dhe statistikave që kanë të bëjnë me ekonominë bujqësore-duke synuar të dhëna për tërë sektorin , për një varg prodhimesh të ndryshme, llojeve të ndryshme të pronësive dhe për ekonominë shtëpiake bujqësore.

### **A3: Regjistrimi i bujqësisë/Regjistri i fermave**

Statistikat bujqësore të plota dhe të detajizuara sipas rajoneve nuk mund të arrihet pa një regjistrim të bujqësisë. Ky regjistrim po ashtu do të ofrojë kornizën e parë të plotë të mostrës për anketat e mëvonshme.Do të jetë çështje e metodave dhe ekonomisë se a do të ketë nevojë për një regjistrim pilot , ose regjistrimi pilot mund të përfshihet nën Regjistrimin e Popullsisë dhe Banesave. Nëse ky regjistrim do të mund të realizohet më 2004, mundësia për vitet e para të Regjistrimit të Bujqësisë mund të jetë viti 2006.

Në projektin "Aftësimi i Shërbimeve Veterinare në Kosovë" është planifikuar ndërtimi i regjistrimit të fermave. Regjistrimi i gjedheve, deleve dhe dhive do të krijojë një bazë për statistika të bagëtive – por kjo nuk mjafton. Por vetë regjistri do të ketë më shumë rëndësi për statistikat e bujqësisë në përgjithësi. Një bashkëpunim i ngushtë është thelbësor për zhvillimet e statistikave të mëtutjeshme në këtë fushë.

### **A4: Regjistri i pronësive / kadastrës**

Të fillohet me gjetjen e fakteve dhe projektin e studimit plotësues, se kur dhe si është regjistruar prona e cila ka rëndësi për statistika, veçanërisht në lidhje me regjistrimin, anketat bujqësore , shfrytëzimin e tokave, kodifikimin dhe pozicionimin gjeografik.

#### **A5: Statistikat e ambientit**

Rekomandohet studimi për nevojat dhe mundësitë e statistikave të ambientit. Studimi duhet të përfshijë trajnimin në metoda dhe standarde në këtë lëmi.

#### **A6: Ndryshimet në sigurimin e vendbanimeve**

Është propozuar projekti për të hulumtuar mundësinë për krijimin e statistikave për shtëpi dhe vendbanime të bazuar mbi rutinat administrative dhe të dhënat. Ky projekt ka lidhje me planifikimin dhe realizimin e regjistrimit të popullsisë si dhe mundësinë e regjistrimit të mirëfilltë.

### **5.5 Statistikat sociale**

#### **Hyrje**

Përmirësimi i kushteve të jetesës për popullsinë e Kosovës është çështje kyçe. Të dhënat mbi gjendjen dhe zhvillimin e shumicës së komponenteve të rëndësishme të mirëqenjes deri tani janë të pamjaftueshme. Politikanët, administratorët dhe donatorët në të vërtetë duke shikuar për njohuri rreth situatës dhe për efektet e vlerësimeve të duhura. Me anë të statistikave janë bërë angazhime për të plotësuar vakumin e të dhënave qenësore.

Për themelimin e etapës së parë, në fund të vitit 2000 është realizuar Anketa për Matjen e Standardit të Jetesës (AMSJ/LSMS) në bashkëpunim me Bankën Botërore, donatorë tjerë dhe ESK. Raporti për Vlerësimin e Varfërisë ka cekur situatën shumë të rëndë të një pjese të madhe të popullsisë. Projekti është financuar nga programi financues i Sidës për statistikave ekonomike. Dy objektivat për ABF janë sigurimi i inpueteve për Llogari Kombëtare dhe indeksin e çmimeve të komsumit në të ardhmen. Megjithatë në kontekstin e statistikave sociale, objektiva e tretë shtrihet më shumë në fokusin- dmth në rezultimin e statistikave të varfërisë dhe kushteve të jetesës psh për arsimin, të ardhurat, standardet e strehimit, mallrave afatgjate.

Grumbullimi i të dhënave të Anketës së parë të Fuqisë Punëtore (AFP) është realizuar në vjeshtë të vitit 2001. Rezultatet kryesore janë prezantuar në Qershor të këtij viti, por rezultatet përfundimtare janë ende në vazhdim. AFP e dytë do të realizohet kësaj vjeshte. Për tri anketat e ekonomive shtëpiake –të bujqësisë, buxhetit dhe punësimi- është përdorur teknika e mostrës së koordinuar. Për të pasur kornizë më të mirë dhe më të besueshme veçanërisht për rezultate , është ne qartë se ndjehet nevoja për një regjistrim të popullsisë.

Enti i Statistikave të Kosovës gjithashtu ka filluar punën në fusha të tjera të statistikës. Është botuar një publikim ambicioz i arsimit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe UNICEF-it. Më shumë statistika rreth sistemit të arsimit, vijimit shkollor ejt janë në përpunim dhe shumica bazohen në Sistemin Informativ Menaxhues të Arsimit (SIMA). Diskutime dhe bashkëpunime me ministrinë përkatëse dhe trupave tjerë janë duke u bërë , për t'i zhvilluarose shfrytëzimin e sistemeve të ngjajshme të statistikave mbi kujdesin shëndetësor, krimin, kulturën, sportin dhe turizmin.

Divizioni i statistikave sociale në ESK përfshinë një numër të lëmive kryesore. Deri më tani numri shumë i kufizuar duhet të mbërthejë njohuri të gjërë të rrethit dhe ndërkohë t'ia dalë me lloje të ndryshme të burimeve të të dhënave dhe metodave që janë të aplikueshme në këto degë të ndryshme të statistikës.

## **Veprimtaritë/ projektet e propozuara**

### **S1: Zhvillimi i programit të anketës së ekonomive shtëpiake**

Qëllimi i programit të anketave të ekonomive shtëpiake është i dyfishtë . Së pari nevoja për të dhëna të rregullta për të arritur trendet e zhvillimit ( dy herë në vit ose çdo tre muaj). Së dyti është efikasë të përdoren anketat për qëllime të ndryshme , që do të thotë mund të mbulojnë lëmi të ndryshme. Një program i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës duhet elaboruar dhe vendosur rreth tij. "Të vazhdueshëm" në këtë kontekst së pari nënkuptonë financim i përhershëm për punëtorët e ESK-së në mënyrë që t'i marrin përgjegjësitë për angazhim afatgjatë - pjesë shumë qenësore këtu është organizimi në terren i zyrave rajonale, burimeve dhe kushteve të tyre.

Programi duhet të ndërtohet mbi përvojën nga anketat e realizuara. Programi duhet të jetë instrument për grumbullimin e të dhënave të rregullta me një dizajn të mostrës që synon në realizimin efikas për termet e kostos dhe të kualitetit. Programi duhet të jetë i dizajnuar të mbuloj shumicën e komponenteve të rëndësishme të ekonomisë së ekonomive shtëpiake dhe mirëqenës. Të dhënat mbi konsumin e ekonomisë shtëpiake, mënyrës dhe vëllimit janë me rëndësi të përcillen në baza të rregullta.

Hulumtimet e thellësishme mbi lëmitë e caktuar mund të ndërrohen dhe ndërprehen –të themi për një interval pesë vjeçar. Anketa e Fuqisë Punëtores duhet të financohet në periudhë gjysmë vjetore. Metodat e mostrës dhe të zënjes së të dhënave duhet të zhvillohen vazhdimisht dhe duhet të rritet kapaciteti për analiza dhe raportim. Kornizat kohore për realizim dhe publikim duhen të shkurtohen.

### **S2: Realizimi i anketave të rregullta të ekonomive shtëpiake**

Ideja e përgjithshme për pasur anketa të rregullta të ekonomive shtëpiake mundësisht që të kemi organizim efikas i cili do të japë sa më shpejtë trende të zhvillimit. Programi i anketave të rregullta do të jetë i lehtë për përdorim dhe për pyetjet e reja aktuale, të cilat mund t'i shtohen pyetësorit bazik për ekonominë e ekonomisë familjare, kushteve të jetesës etj.

Realizimi i programit të vazhdueshëm me siguri do të jetë çështje e qeverisë për financim. Asistimi ndërkombëtar në këtë kontekst do të jetë rast për marketing dhe punë koordinimi, ku shfrytëzuesit e ndryshëm në shoqëri duhet t'ju qasen dhe ti binden logjikës së sistemit të rregullt.

### **S3: Indikatorët e kushteve të jetesës**

Të dhëna e caktuara për kushtet e jetesës janë grumbulluar përmes anketave të fuqisë punëtores, buxhetit familjar dhe bujqësor. Variablat tjera mund të mbuloohen psh duke përcjellur statistikën e arsimit. Duhet të planifikohen dhe të realizohen për të dhënë indikatorë të krahasueshëm për kushtet e jetesës, të grumbulluar dhe publikuar në baza të rregullta. Përvojat, standardet dhe etapat mund të mirren nga vendet e tjera dhe organizatat.

Të dhënat për shkaqet e vdekjeve mund të pasqyrojnë segmente të kushteve të jetesës. Prandaj duhet të fillohet nën-projekti i cili do të sqarojë se si dhe kur statistikën për shkaqet e vdekjeve mund të elaborohet. Qartë është parashikuar nevoja për këto të dhëna. Formularët për raportimin e vdekjeve nën regjistrimin civil janë përgatitur për grumbullimin e të dhënave relevante dhe ESK është e gatshme të përkujdeset për përfshirjen e të dhënave, grumbullimin dhe prodhimin e statistikave. Sot instituteve të cilat duhet të japin të dhëna dukshëm ju mungojnë burimet për plotësimin e kësaj detyre.

### **S4: Kujdesi shëndetësor, arsimit , krimi, kultura dhe turizmi**

Puna në statistikën ekonomike tanimë është e frytshme. Janë idetë ose planet paraprake se si të shkojnë më tutje në lëmitë tjera të këtij titulli. Përparësi duhet dhënë shëndetësisë dhe arsimit. Plani gjithëpërfshirës duhet të elaborohet, të punohet në

vargjet(lines) prodhuese, nevojat për paisje, punëtorët dhe asistimi i verifikuar, ekipet e zgjedhura të projekteve, dhe orarai për publikime dhe kumtesat e vendosura. Ka edhe nevoja tjera si trajnimi në TI, analiza dhe publikime. Insiprimi dhe përkrahja do të mirret nga jashtë.

## **5.6 Statistikat e fushave të shumta**

### **Projektet /aktivitetet e propozuara**

#### **M1: Divizionet rajonale dhe statistikat**

Tridhjetë komunat e Kosovës gradualisht janë duke iu rikthyer përgjegjësi në realizimin e shërbimeve publike ndaj popullatës. Rishtazi i kanë marrë të drejtat për të mbledhur disa tatime. Mbi të gjitha nevojiten infotmatat për popullsin, punësimin, shfrytëzimin e tokës, zhvillimit të ndërmarjeve të vogla. Pasi që statistikat e Kosovës deri më tani kanë qenë kryesisht të bazuara mbi anketat me mostra relativisht të vogla, ku mundësitë për të dhënë statistika sipas rajoneve janë shumë të kufizuara. Përrjashtime këtu kanë statistikat vitale dhe të arsimit. Pasi që në vitet e ardhshme do të paraqiten burime të reja të të dhënave do të jetë shumë me rëndësi përgatitja e prodhimit të statistikave sipas rajoneve. Qëllimi kryesor për regjistrimet e ardhshme do të jetë realizimi i statistikave regjionale për shfrytëzuesit vendor, rajonal dhe të nivelit qendror. Madje edhe statistikat e bazuara në burimet administrative kanë potencial të jenë sipas rajoneve.

Është një sistem divizionimi hiererikal rajonal në Kosovë, ku në nivelin e parë janë komunat dhe diku rreth 1400 qarqe statistikore, në të dytin. Këto divizione përfshijnë mbulimin e hapsirave “fshatra” (jo “aglomeratin”) në vendet rurale dhe pjesët e qyteteve në rretina urabane. Parimisht sistemi ishte pjesë për organizimin e realizimit të një regjistrimi dhe ka qenë qenësore për disa vite. Për aryet e ardhshme sistemi duhet të rifillohet, shqyrtohet dhe nëse është e nevojshme të modifikohet.

#### **M2: Kryq-sektori i publikimeve**

Është një nevojë e madhe për çasje të të dhënave të përgjithshme dhe të besueshme për shoqërinë e Kosovës. Pra detyra e parë është përmbushja e kësaj kërkesë mundësisht sa më shpejt hap pas hapi. Mund të thuhet se duhet të shfrytëzohet situata për përmisimin e statistikave, entit statistikor dhe rolit dhe vlerave të statistikave zyrtare në shoqëri.

Për arritjen e këtyre qëllimeve janë produktet tipike si vjetarët statistikorë dhe buletinët mujor dhe tremujorë. Në vitet e fundit ëeb-faqet janë bërë shumë të rëndësishëm dhe kanë arritur numër shumë të madh të shfrytëzuesve. Të dyja zgjedhjet janë propozuar për Kosovë. Botimet e botuara duhet të planifikohen dhe vihen në botimet e reja dhe në ëeb-faqja e re e ESK-së duhet të shrytëzohet si mjet i integruar për shpërndarjen e informacioneve.

#### **M3: Indikatorët Ekzekutues**

Për shfrytëzuesit më të avansuar të statistikave brenda dhe jashtë Kosovës, ministrive, administratës së UNMIK-ut. OJQ-ve dhe donatorëve- do të ishin më se të mirëseardhur grumbullimi dhe botimi i “indikatorëve ekzekutues”. AQF ka bërë një fillim të mirë me publikimin e “Monitorimi i Makro-ekonomisë në Kosovë” dhe UNDP-ja ka bërë lansimin e raportit të parë “Sistemi i hershëm lajmërues” i realizuar nga instituti i RIINNVESTIT.

Është propozuar themelimi i një detyre speciale/projekt i cili kishte për të shiquar mbi nevojat dhe mundësitë për definimin dhe prodhimin e indikatorëve të tillë, ku ju gjithashtu mund të veçoni kualitetin e parametrave të ndryshëm.

#### **M4: Statistikat në funksion**

Të gjitha kërkesat nuk mund të përmbushen më statistikat zyrtare të financuara nga qeveria. Shfrytëzuesit e interesuar në të njëjtën kohë të dhënat mund të marrin nga

agjencioni kryesor statistikor si të kombinuara, të tabeluara ose të analizyara për qëllime speciale. Pyetjet shtesë në anketat në realizim ose anketat e dizajnuara speciale mund të jenë mjete tjera për të mbuluar kërkesat e tregut statistikor. Prandaj, shumica e zyreve publike statistikore kanë mundësinë e prodhimit të statistikave sipas kërkesave të shfrytëzuesve në publikun privat si dhe atë shoqëror. Për t'a bërë këtë ju duhet politika mirë e elaboruar e biznesit më të cilën duhet të fillohet- të udhëzohen akcionet e punëtorëve për të mbrojtur besueshmërinë dhe pavarësinë e statistikave dhe entit statistikor. Komisionet duhet t'i ikin reziqeve në realizime; shumë zyre nuk realizojnë psh. anketat e tregut për prodhimet ose shërbimet e konsumit.

Për përgatitjen e statistikave të caktuara është propozuar një projekt i veçantë për ESK-në që ka të bëjë me çështje legale dhe politike dhe shiqimin e mundësive të tregut dhe metodologjinë më të përshtatshme në treg. Nëse këto kushte hulumtimi nuk janë të mjaftueshme atëherë duhet të punohet një plan konkret i aktiviteteve. Ky plan duhet të përmbanë gjithashtu përgatitjet teknike për prodhimin e statistikave të tregut në përgjithësi.

## **5.7 Projekti për infologji, bazë e të dhënave dhe shpërndarja e tyre**

### **Historiku**

Sot fabrikimi i statistikave në ESK mund të karakterizohet si një numër i ndarë i linjave paralele në prodhim. Çdo prodhim/anketë/hulumtim ka rrjedhën e vet të përfshirjes së të dhënave, ruatjen e tyre, kalkulimin dhe tabelimin edhe në qoftëse përdoren disa programe të zakonshme në faza të ndryshme. Kjo është e natyrshme dhe gati mënyrë e pashmangshme për organizimin e prodhimit ku pjesa kryesore e sistemit statistikor përbëhet prej anketave në degë të ndryshme.

Megjithëate kur një numër dhe lloji i të dhënave burimore rritet – psh me regjistrim dhe regjistra administrativ- dhe veçanërisht kur shtohen kërkesat e shfrytëzuesve më të sofistikuar për rishfrytëzimin dhe kombinimin e të dhënave, në një mënyrë tjetër duhet të organizohen segmente të fabrikimit. Të dhënat e grumbulluara bëhen në vendin qendror. Materiali i papërpunuar dhe komponentet duhet të përshtatohen dhe të ruhen mirë dhe inventari duhet të mbahet nën një kujdes rreptë. Për të hulumtuar qendrën e të dhënave dhe për të shkurtuar kohën e udhëheqjes, logjistika, makineria dhe metodologjia e punës duhet të avansohen. Fabrikimi duhet të planifikohet më kujdes dhe të organizohet në themel dhe të dizajnohet për ndryshime dhe rezultate fleksibile në nivele të larta.

Për arkivim të rrëgjullt dhe fleksibil të këtij kombinimi ekzistojnë disa disiplina, metoda dhe terme si: infologjia, modelimi i koncepteve, sistemi i bazës së të dhënave, orientimi i objektit dhe struktura e meta-data. Është propozuar të fillohet me disa projekte vlerësimi krahas këtyre konturave të ndërmarra. E gjithë kjo nënkuptohet pasi që në ESK ka punëtorë për përkrahjen e TI-së. Sot kjo është shumë e vogël dhe gati plotësisht e financuar nga KB ose donatorë të tjerë. Niveli i pagave në krahasim me tregun privat këtu është gjithashtu një problem i dukshëm. Pasi që ju duhet të investoni në trajnimin e punëtorëve të TI-së, ju gjithashtu duhet pasur mjete për ti mbajtur ata në punë së paku për disa vite.

### **Aktivitetet/projektet e propozuara**

#### **Pr1: Projekti i metodave prodhuese në të ardhmen**

Projekti synon dhe rekomandon mësimin dhe mendimin krahas sistemit modern dhe metodave statistikore të punës në TI. Duhet përgatitur punëtorët e TI si dhe punëtorët e lëmive kryesore të marrin pjesë në dizajnimin e sistemit të ri integruar, të krijuar nga disa baza të zakonshme të të dhënave.

**Pr2: Plani i publikimeve, përshkrimi kualitativ**

Për dushmërinë e statistikave dhe ESK-së dhe për t'iu dhënë shfrytëzuesve mundësitë për planifikimin e furnizimit të tyre me informacione statistikore është e qartë nevoja për planin e publikimeve. Shtojca e saj duhet të përmbanë metoda që përmbajnë përshkrime kualitative për prodhime të ndryshme statistikore. Eksitojnë standarde për deklarata të tilla. Kjo punë duhet të koordinohet në shumë pjesë të sistemit zhvillimor.



## **6 Kapaciteti ndërtues**

### **6.1 Programi për zhvillimin e kuadrove dhe udhëheqja e stërvitjeve**

Ndërtimi i kapacitetit është një ndër pikat kryesore në planin zhvillimor. Pjesa më me rëndësi e ndërtimit të kapacitetit është transferimi i njohurisë se si të zhvillohet, mirëmbahet dhe funksionoj sistemi modern statistikor. Sipas planit ky transferim mund të bëhet përmes disa aktiviteteve në intervale të ndryshme. Dy pjesë të programit të sygjëruar do të jenë kritike për përfundim; të dedikuara udhëheqjes dhe këshilltarëve me angazhim afatgjatë.

#### **H1: Stërvitja për Udhëheqje**

Për ta ndërtuar organizimin, ndërrimin e sjelljeve dhe themelimin e rutinave të reja me shprehje të reja duhet punë dhe përkushtim i madh. Kjo është e pamundur të realizohet pa një udhëheqje të mirë, si në nivelet më të larta po ashtu edhe në ato të ulëta. Udhëheqja e mirë karakterizohet më përkushtim ndaj firmës dhe miratimit të principeve, rrjedhave, inkurajimit, delegacionit përgjegjës dhe respektit për të gjithë personat dhe llojet e kualifikimeve mes punëtorëve. Programi për stërvitjen e punëtorëve udhëheqës duhet të zhvillohet dhe të realizohet. Të gjitha pozitat udhëheqëse duhet të rishpallen dhe të kërkohen punëtorë për pozita të ndryshme.

#### **H2: Udhëheqja personale**

Vetë programi i burimeve për kuadro është operacion voluminoz dhe ka kërkesa shtesë të burimeve për udhëheqje gjatë kësaj periudhe. Sygjerohet që menaxheri special i punëtorëve, drejtëpërdrejt t'i raportoj udhëheqësit kryesor i cili duhet ta monitoroj këtë program.

#### **H3: Programi për zhvillimin e kuadrove**

Ky program synon që çdo pozitë në sistemin statistikor të plotësojë më persona kompetent dhe aftësi për punë. Programi përmban plane kompetente zhvillimore për të gjithë punëtorët në sistemin statistikor. Kjo do të thotë plane individuale për "stërvitje në punë" dhe kurse të brendshme dhe jashtme në gjuhën angleze, në statistikë, etj. Në shumë raste do të ketë udhëtime për një ose dy javë jashtë në agjencionet tjera statistikore. Punëtorët profesional të të gjitha pjesëve të sistemit duhet të kenë mundësinë të punojnë si praktikantë për tre deri në gjashtë muaj në agjencitë tjera statistikore. Programi gjithashtu përfshinë trajnim special për grupe të ndryshme si udhëheqës, udhëheqës projektësh, punëtorë të TI –së, statisticient etj.

Për të dizajnuar një program nevojiten tri faza përgatitore:

- Të dokumentohet profili i kompetencave aktuale për çdo individ
- Vendimi mbi kriteret e kompetencave për çdo pozitë
- Vendimi mbi planin zhvillimor të kompetencave të arsyeshme për çdo individ.

Në përgjithësi, propozimi dmth program për stërvitje të vazhdueshme si pjesë e rëndësishme e planit në tërësi. Programi gjithashtu ka për tendencë t'a rrisë motivimin e punëtorëve në marrjen e përgjegjësisë të reja. Për të filluar këtë program nevojiten seri të misionëve të shkurtëra të punëtorëve të specializuar (ekspertë). Specialisti do të sjellë teknikë të duhur për dokumentim efikas dhe për procesin e marrjes së vendimit, për definimin e kriterëve dhe të pozitave të ndryshme. Specialisti gjithashtu do të bëjë stërvitjen e udhëheqësit në monitorimin e programit.

Programi duhet të fillojë së pari me një seri të seminareve për udhëheqje me bordin e drejtorëve dhe personelin e specializuar. Qëllimi i këtyre seminareve do të jetë, që të arrihen konkluzione për rëndësinë dhe drejtimin e këtij programi.

## 6.2 TI dhe Metodatat Statistikore

### TII: TI, pajste dhe sistemet

Është zhvilluar politika e TI-së për ESK. Divizioni i TI gjithashtu ka paraqitur planin për zhvillimin e sistemeve dhe paisjeve. Duke iu falënderuar projekteve të Sidës është bërë një përmirësim i konsiderueshëm në dy vitet e fundit. Më tepër do të vijë nëse arrihet marrëveshja mes UNMIK-ut dhe Sidës mbi doganë dhe TVSH. Rishtazi Ministria e Shërbimeve Publike ka marrur vendim mbi politikën e softuerëve dhe harduerëve për qeverinë e Kosovës dhe agjencionet kombëtare. Ky dokument nënkupton avansimin gjeneral, koordinimin dhe standardizimin e paisjeve dhe softuerëve. Ngritja më masive dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i burimeve të TI është propozuar si vijon:

- KP me standarde dhe uniformë moderne për të gjithë punëtorët
- Serverë në të gjitha divizionet dhe zyrat rajonale
- RFL (LAN) për zyrë qendrore dhe paisje komunikimi për zyrat rajonale
- Qasje në postë elektronike për të gjithë punëtorët dhe qasje të gjerë të Internetit për të gjitha divizionet dhe zyrat për kontakte dhe prodhues të tjerë, agjencione ndërkombëtare etj.
- Licenca për softuerë(programe) të caktuara.

Departamenti i TI nën Ministrinë e Shërbimeve Publike ofron trajnim elementar në programet e zakonshme si Microsoft Office – dhe kjo është gjë e mirë, një burim që duhet shfrytëzuar. Por kjo është larg nga e mjaftueshmja për të krijuar kuadro të afta për zhvillimin e sistemeve për prodhimin e statistikave – ose kërkesave të ngjajshme. Ju keni nevojë për kurse të avansuara psh në modelimin e të dhënave, strukturave të bazës së të dhënave dhe programe me mjete moderne. Sipas njohurisë së këtij projekti nuk ekziston arsimim i tillë në Kosovë – së paku jo i rregulluar nga sektori publik. Duhet të bëhen hulumtime të mëtutjeshme se si të eliminohen këto pengesa.

### Met1: Metodatat statistikore

ESK nuk ka njësi të metodave statistikore. Gati të gjitha çëshjet metodologjike duhet të zgjidhen nga këshilltari i huaj. Kjo duhet të bëhet për një kohë të shkurtër, por në perspektivë ESK-së i duhen ekspertët e saj. Nevojat e dukshme do të shfaqen dhe kanë të bëjnë:

- Mostrimi
- Formulimi i pyetjeve
- Regjistrave statistikor
- Teknikave të analizave
- Mbrojtja e të dhënave
- Prezantimi dhe shpërndarja e të dhënave.

Po të mos mund punësohen ekspertët metodologjik në ent, duhet të stërviten kandidatët e brendshëm. Stërvitja duhet të fillojë menjëherë pasi që do të merr kohe të konsiderueshme. Kandidatët e interesuar duhet të inkurajohen që të marrin kurse në statistikat e jashtme dhe të shfrytëzojnë mundësinë për të punuar si praktikant në agjencionet e huaja statistikore.

### Met2: Kurse Universitare

Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës sot mund të ofroj kurse statistikore, të nivelit fillestar dhe nuk janë të mjaftueshëm të plotësojnë kërkesat e prodhuesve-shfrytëzuesve statistikor. Kontaktet me universitetin tregojnë se ka një interesim të madh për vazhdimin e programit ekzistues me kurse të avansuara statistikore. Procesi do të fillojë me vizitat e profesorëve nga univeristetet tjera dhe është rekomanduar bashëpunimi sistematik me ESK-në.

## **7 Çështjet koordinuese, rregullativa ligjore dhe aktivitetet përkrahëse**

### **Hyrje**

#### **7.1 Rregullat ligjore dhe përgjegjësitë**

Sistemi kombëtarë statistikor prodhon informacione për shfrytëzues të ndryshëm në shoqëri dhe në publik. Sistemi paraqet rolin e tij në përgjithësi me ligj të veçantë për statistika ose rregullore statistikore. Për këtë qëllim shërben Rregullorja Nr.2001/14 mbi themelimin e Entit të Statistikave të Kosovës. Rregullorja mbulon çështjet më kryesore statistikore dhe jep udhëzime të qarta për përgjegjësitë, funksionet dhe principet e konfidencës dhe obligimet e përgjegjësve.

#### **Roli i ESK-së**

Sipas Rregullores 2001/14, ESK është i vetmi agjencion për prodhimin e statistikave zyrtare në Kosovë. Një përjashtim i pranuar do të jetë BPK e cila ka marrë përgjegjësinë për Statistikat Bankare dhe Monetare dhe do të jetë prodhues i statistikave të Bilancit të Pagesave në të ardhmen. Si agjencion kryesor ESK –së iu ka dhënë autoriteti të grumbulloj, tabeloj dhe shpërndaj statistikave zyrtare. Më statistika zyrtare nënkuptojmë informatat për nevojat themelore të shoqërisë. Statistikat zyrtare zakonisht kanë karakter të shumëfishtë dhe më shumë shfrytëzues.

Regullorja e lartpërmendur i mundëson ESK që të inicioj rregulloret e reja të nevojshme dhe të jap udhëzime të caktuara për furnizuesit e të dhënave dhe agjencioneve tjera publike. Disa kontakte tregojnë nevojën për rregullore më të qarta dhe precize sa i përket furnizimit të të dhënave statistikore.

#### **Roli i agjencioneve tjera publike**

Duke pasur parasysh gjendjen aktuale të punëve në prodhimin e statistikave të Kosovës disa komente duhet përvetësuar:

- AQF/MEF tani është duke prodhuar vlerësimet e PBB dhe duke publikuar rregullisht të dhënat makro-ekonomike. Këto të dhëna aktualisht janë të vetmet që pasqyrojnë ekonominë e Kosovës. Statistikat e AQF/MEF janë të bazuar në burime të ndryshme. ESK deri më tani nuk ka pasur mundësi të prodhoj statistika zyrtare në këtë fushë. Në të ardhmen statistikave zyrtare duhet të ndërtohen në burime tjera, të rregullta dhe do të jetë përgjegjësi e ESK.
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka punëtorë të kualifikuar për analizat statistikore dhe dizajnimin e anketave në sektorin e bujqësisë. Megjithatë ministria duhet të realizoj anketat me qëllim të prodhoj statistika zyrtare. ESK do të jetë përgjegjës për prodhimin e statistikave të rregullta zyrtare dhe për regjistrimin e bujqësisë.
- Agjencionet tjera publike, si Ministria për Punësim dhe Mirëqenje Sociale, gjithashtu prodhon statistika në fushën përkatëse të përgjegjësisë. Në shumicën e rasteve këto statistika mund të shihen si statistika të prodhuara për shfrytëzim në punën e realizuar brenda ministrive përkatëse. Gumbullimi i të dhënave plotësisht për qëllime administrative dhe monitorimi nuk janë anketa statistikore dhe statistikave të tilla nuk konsiderohen si statistika zyrtare.

#### **7.2 Propozimet**

##### **C1: ESK e pavarur**

Pasi që ESK është nën Ministrinë e Shërbimeve Publike, ajo nuk është zyre e pavarur statistikore siç nënkuptohet në shumicën e shteteve. Edhe pse nuk ka pasur ndonjë problem që ka të bëjë me pavarësinë profesionale, ESK në të ardhmen duhet të bëhet agjencion publik në vete duke i ndjekur principet kryesore të shpallura nga KB. Ky projekt ende nuk ka hasur në ndonjë opinion tjetër mbi këtë çështje.

## **C2: Rregulloret e Reja**

ESK ka mundësi të propozojë rregullore të reja kur është nevoja. Kjo mundësi duhet shfrytëzuar. Rekomandohet që këto çështje të përgatiten nga ESK dhe të diskutohen nga Komisioni Koordinues Statistikor. Kandidatë për rendin e ardhshëm të ditës duhet të jetë rregullorja e cila i adresohet të drejtave për kërkimin e të dhënave nga sektori publik me qëllim të prodhimit statistikave. Rregullore më precize për grumbullimin e të dhënave nga bizneset gjithashtu mund të jetë e nevojshme.

Tani nuk ka nevojë të mënjëhershme për përkrahje speciale të këtij projekti.

## **C3: Komisioni Koordinues Statistikor**

Sipas rregullores ESK do të koordinoj organizatat publike me respekt ndaj shërbimeve statistikore dhe të avansoj zhvillimin koherent. Këto aktivitete duhet të konsolidohen dhe formalizohen në një rregullore të re ose si amendament i rregullores ekzistuese. ESK si prodhues i statistikave zyrtare është me rëndësi të ketë kanal të mirë informimi dhe një forum për diskutime të çështjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me statistikave zyrtare. Komisioni duhet të veprojë si bord këshillues mbi çështjet vijuese që kanë të bëjnë me statistikave zyrtare:

- Strategjitë afatgjate, plani zhvillimor dhe realizimin e planeve
- Çështjet legale, rregulloret
- Metodatat dhe standardet
- Prodhimi i statistikave zyrtare, çështjet prioritare
- Plani shumëvjeçarë
- Plani vjetor

Drejtori i ESK duhet t'a udhëheq komisionin. Një alternativë e cila është diskutuar është që Komisioni duhet udhëhequr nga zyrtari i lartë nga Zyra e Kryeministrit ose Ministrisë së Shërbimeve Publike. Anëtarët e tjerë të komisionit duhet të paraqesin shfrytëzuesit dhe prodhuesit dhe interesave tjerë:

- Ministritë
- Komunitat
- OJQ
- Sektori Privat
- Shkenca dhe hulumtimet
- Media dhe publiku i gjithëmbarshtëm

Komisioni duhet të ketë funksion sekretariati që ka lidhje me drejtorët e ESK.

## **C4: Ekipet Punuese**

Për arsye praktike, ekipet punuese mbrenda ministrisë janë themeluar në fusha të ndryshme. Ata duhet të vazhdojnë punën e tyre dhe grupe të tjera duhet të krijohen nëse parashifet nevoja.

Në fushën e statistikave ekonomike, aktivitetet i veçantë duhet themeluar për koordinimin e planifikimit dhe realizimin e dy projekteve të mëdha të financuar nga Sida dhe AER, e cila mbi të gjitha synon zhvillimin e Llogarive Kombëtare. Shiqoni propozimet E1. Ky grup gjithashtu duhet të kujdeset rreth disa çështjeve urgjente statistikore mbrenda fushës-psh se a gjindet ndonjë zgjedhje e mirë në afat të shurtër për plotësimin e vakumeve me qenësore të informatave.

Duhet themeluar veprimtari paralele për statistikave e bujqësisë. Shiqo propozimin A1.

## **C5: Veprimtaritë tjera përkrahëse**

Për avansimin e statistikave të shoqërisë Kosovare duhet të zhvillohet një program. Qëllimi i këtij programi do të jetë dhënia e informacioneve për shfrytëzues, prodhues dhe publikut në përgjithshëm. Gjithashtu duhet të japë mundësitë për diskutim mes partive të interesuara. Në këtë program do të ketë mundësi për disa aktivitete si:

- Seminarë për shfrytëzues, vendim-marrës, prodhues, akademi

- Seminarë të veçantë për media
- Seminarë të veçantë për publikun e përgjithshëm
- Krijimi i "Shoqërisë Statistike të Kosovës".

## **8 Përmbledhje e propozimeve; mjetet, fondi dhe kohëzgjatja**

Në faqet vijuese janë përmbledhur propozimet më pakë tekst dhe tri tabela për të dhënë një pasqyrë. Synimi i përgjithshëm i këtij plani është të ndihmoj ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm statistikor. Me financim nënkuptojmë mjetet me të cilat sistemi mund të funksionoj dhe zhvillohet pa ndihmën e jashtme. Prandaj financimet e jashtme do të shfrytëzohen në ndërtim dhe bartjen e njohurive. Fondi i donatorëve nuk do të shfrytëzohet në afatë të gjatë për prodhimin e statistikave të rregullta.

### **Shtrirja e ESK, financimi qeveritar**

Nevoja për rritjen e prodhimeve statistikore do të kërkojë më shumë punëtorë të kualifikuar dhe gjithashtu më shumë kuadër në ESK. Ky propozim tregon një rritje të punëtorëve rreth 10 përqind në vit. Ky vlerësim dmth një ndryshim modest që ka të bëjë me nevojën urgjente për statistika krahasuar më rrijen parashikuar në rezultatet statistikore. Arsyet qëndrojnë këtu. Kapaciteti i punëtorëve aktual nuk është i mjaftueshëm. Më shumë mund të prodhohet, më sigurin e kushteve të duhura në aspektin e trajnimeve profesionale, motivimit dhe teknikës. Por gjithashtu merr kohë dhe angazhim për të ndërtuar kapacitetin, kualitetin dhe vazhdueshmërinë, të cilat nuk mund të zhvillohen shumë shpejt.

Në fund të vitit 2002 ESK ka buxhetin i cili mbulon 125 të punësuar, rreth 50 të punësuar në zyrat rajonale dhe jo më tepër se 40 të punësuar në divizionet e lëmive. Brenda tre viteve të ardhëshme numri i të punësuarve duhet të rritet në 165 sipas planit –shiqoni tabelën 1. Ky numër i punëtorëve duhet të financohet nga qeveria.

### **Këshillëtarët afatëgjatë**

Në të gjitha divizionet ka detyra të reja me rëndësi që duhen të përmbushen. Për të mundësuar stërvitjen e punëtorëve vendorë dhe që gradualisht të marrin përgjegjësinë juve ju duhet stabiliteti dhe këshillat nga një statistikant me përvojë. Këshillëtarët në afat të gjatë kanë rëndësi të veçantë për planin zhvillimor të sistemit statistikor. Ata do të shëbejnë shtylla ndërtuese për realizimin dhe përkrahjen e këtyre aktiviteteve. Propozimet nënkuptojnë këshillëtarë në afat të gjatë në divizionin ekonomik dhe nga një në secilin nga divizionet tjerë (përveç administratës), gjithsej 15 vite të kalkuluar - shiqoni tabelën 2.

Këshillëtarët në afatë të gjatë duhet të caktohen minimum për 12 muaj, mundësisht edhe më gjatë. Ata duhet të kenë kualitetet e caktuara – ekspertë në fushën e tyre, por gjithashtu me standarde të larta si mentorë dhe stërvitës:

- Së paku pesë vite përvojë në fushën statistikore
- Aftësi të vërtetuara për transferimin e njohurive, mësimdhënjes/ose bartjen e përvojës
- Qëndrim pozitiv, përkrahës dhe joautoritativ.

Deturat e tyre në përgjithësi do të jenë udhëheqja e e detyrave zhvillimore në lëmitë kryesore, stërvitjen e punëtorëve vendorë në punë dhe bartja e përgjegjësi në punëtorët e përhershëm.

Përvoja tregon që këshillëtarët në afat të gjatë shpesh bëhen prodhues të statistikave në vend të jenë mësimdhënës dhe mentorë. Në rastë të këtilla këshillëtarët nuk bartin njohurinë por përmbushin hapësirat. Ka mundësi t'i shmanget kësaj shtate me kontrata të specifikuar dhe këshillëtarët të monitorohen me kujdes.

### **Këshillëtarët në afatë të shkurtër**

Seritë e këshillëtarëve më afat të shkurtër janë propozuar për hulumtime të kufizuara ose arsimim. Gjithsej janë llogaritur 36 muaj këshillimi - shiqo tabelën 3. Në shumicën e rasteve këta muaj do të ndahen në misione të shkurtëra një apo dy javore.

### Aktivitetet e financuara nga donatorët

Në tabelën 3 është dhënë vlerësimi i shpenzimeve të financuara nga donatorët gjithsej për tri vite. Aktualisht ESK ka 5 zyrtarë ndërkombëtar të financuar nga KB dhe dy të financuar nga Sida- shiqoni tabelën 2. Në princip ktu propozimet duhet të kondiderohen si projekte dhe aktivitete të reja në krahasim më veprimin aktual në ESK dhe të vie në radhë të parë buxheti aktual dhe i fondeve ndërkombëtare. Në aktivitetet e propozuara që do të koordinohen të financuara nga doonatorët do të jetë e mungëshme që vlerësimet e shpenzimeve të ceken në më shumë detaje.

Shpenzimet e financuara nga donatorët për periudhen tri vjeçare janë katër milion Euro. Sida dhe UE me siguri do të mbulojnë disa nga aktivitetet e propozuara. Shpenzimet e përmendura do mbulojnë këshilltarët në afatë të gjatë ( 15 vite të llogaritura), këshilltarët në afat të shkurtër (36 muaj të llogaritur), udhëtime studimi, praktikantët, kurse të jashtme, paisje dhe programe për TI. Mënyra e kalkulimit është përshkruar në shtojcen e 5.

Në tabelën 3 përparësitë e projekteve/aktiviteteve janë cekur si I, II ose III, ku përparësi më të madhe ka I. Kohëzgjatja e aktivitetetve është cekur në kolonën e vitit.

**Tabela 1 : Numri i të punësuarëve në Entin e Statistikës së Kosovës**

Divizioni	Shtator	Dhjetor	Propozimet		
	2002	2002	2003	2004	2005
Popullsisë	4				
Statistikat Ekonomike	13				
Bujqësisë, Ambientit	4				
Sociale	8				
Ti dhe Metodologjitë (përf. Përfshirjen e të dhënave)	19				
Administratës (përf. drjetorin)	17				
Nëntotali i Entit Qendror	65				
Zyrat Rajonale	49				
<b>Gjithsej</b>	<b>114</b>	<b>125</b>	<b>135</b>	<b>150</b>	<b>165</b>

**Tabela 2: Numri i ndërkombëtarëve në ESK**

Divizioni	2002		Numri i ndërkombëtarëve të rinjë të propozuar në krahasim më vitin 2002		
	KB	Sida	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Popullsisë	1		1	1	1
Statistikave Ekonomike	1		2	2	2
Bujqësisë, Ambientit	1		1		
Sociale				1	1
TI dhe Metodologjive	1	2	1	1	1
Administrative(përf. Drejtorin)	1				
<b>Gjithsej</b>	<b>5</b>	<b>2</b>	<b>5</b>	<b>5</b>	<b>5</b>

**Tabela 3: Projektet e propozuara dhe financimi ng donatorët**

	Përp.	Viti 1	Viti 2	Vitit 3	Këshillta rë
--	-------	--------	--------	---------	-----------------

<b>Prodhime Statistikore</b>	<b>1900</b>					
<b>Statistika të popullsisë</b>	<b>350<sup>3</sup></b>		<b>1 LTC<sup>4</sup></b>	<b>1 LTC</b>	<b>1 LTC</b>	<b>4 STC<sup>5</sup></b>
P1: Regjistrimi i popullsisë dhe ekonomive shtëpiake		I	Start			
P2 Statistikat aktuale të popullsisë		II		Start		
P3 Statistikat Gjinore		III			Fillon	
<b>Statistikat ekonomike</b>	<b>800</b>		<b>2 KAGJ</b>	<b>2 KAGJ</b>	<b>2 KAGJ</b>	<b>10 KASH</b>
E1. Koordinimi i statistikave ekonomike		I	Fillon			
E2. Stërvitja në Llogaritë Kombëtare dhe zhvillimi i saj		I	Vazhdon	Fillon		
E3. Korniza e mostrës dhe programi i anketës së biznesit		I	Fillon			
E4. Anketet e rregulta të biznesit		II		Fillon		
E5 Indeksat e Çmimeve, tyregtia e jashtme		II	Vazhdon			
<b>Bujqësia, Ambienti</b>	<b>200<sup>6</sup></b>		<b>1 KAGJ</b>			<b>4 KASH</b>
A1. Koordinimi i statistikave të Bujqësisë		I	Fillon			
A2. Anketa e bujqësisë		I	Vazhdon			
A3.Regjistrimi bujqësor		II				
A4. Regjistrimi i pronësive		III		Fillon		
A5. Statistikat e Ambientit		III			Fillon	
A6. Ndërrimi i shtëpive		III			Fillon	
<b>Statistikat Sociale</b>	<b>250</b>		<b>1 KAGJ</b>	<b>1 KAGJ</b>		<b>5 KASH</b>
S1. Zhvillimi i programit të anketave		I	Fillon			
S2. Zbatimi i anketave rrotulluese		II		Fillon		
S3. Treguesit e kushteve të jetesës		II		Fillon		
S4. Kujdesi shëndetësor, arsimi, krimi		III	Vazhdon		Fillon	
<b>Statistikat shumëfushore</b>	<b>150</b>					<b>6 KASH</b>
M1. Statistikat rajonale		II		Fillon		
M2. Sektori i kryqëzuar i publikimeve		II		Fillon		
M3. Treguesit e realizimit		II		Fillon		
M4. Statistikat sipas kërkesave		II		Fillon		

<sup>2</sup>Shpenzimet e vlerësuara në 1000 Euro.

<sup>3</sup> Financimet për regjistrimin e popullsisë nuk janë përfshirë.

<sup>4</sup>KAGJ = Këshilltarë afatgjatë

<sup>5</sup>KASH = Këshilltarë afat shkurtër

<sup>6</sup>Financimi për regjistrimin bujqësor nuk është përfshirë



**Projekti për infologji dhe 150  
shërndarje**

**4 KASH**

Pr1. Projekti mbi prodhimin i  
bazuar mbi regjistrat e ardhshëm

II

Fillon

Pr2. Plani për publikime,  
përshkrimi i kualitetit

III

Fillon

---

**Tabela 3: Projektet e propozuara dhe financimi nga donatorët (Vazhdim)**

		Përp.	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Këshillta rë
<b>Kapaciteti Ndërtues</b>	<b>1700</b>	<b>1</b>	<b>1KAG</b>	<b>1</b>	<b>4 KASH</b>	
		<b>KAGJ</b>	<b>J</b>	<b>KAGj</b>		
<b>Programi për kuadro dhe udhëheqës</b>						
H1. Stërvitja e udhëheqësve		I	Fillon			
H2. Udhëheës për kuadro		II	Fillon			
H3. Progami zhvillimor për kuadro		II		Fillon		
<b>Ti dhe Metodologji</b>						
IT1. Sistemet dhe Paisjet e TI		II		Fillon		
Met1. Motdologjitë statistikore		III		Fillon		
Met2. Kurset universitare		III			Fillon	
<b>Koordinimi, rregullativat ligjore, përkrahja</b>	<b>400</b>					<b>2 KASH</b>
C1. ESK e pavarur		I	Fillon			
C2. Rregullore të reja		II		Fillon		
C3. Komisioni Koord. Statistikor		I	Fillon			
C4. Ekipet punuese		I	Fillon			
C5. Aktivitetet përkrahëse		III		Fillon		
<b>Gjithsej</b>	<b>4000</b>					<b>36 M/KAGJ</b>

<sup>7</sup>Shpenzimet e vlerësuara në 1000 Euro.

## **9 Realizimi i planit zhvillimor**

### **9.1 Koordinimi i donatorëve**

Për realizimin e këtyre propozimeve të këtij plani zhvillimor priten edhe donatorë të tjerë. Dy projekte janë të financuara nga Sida , projektet e statistikave bujqësore dhe të statistikave ekonomike qe janë në vazhdim plus TI. Projekti i financuar nga AER ka filluar për bujqëinë dhe tjetri për statistikave ekonomike është në vazhdim. Gjithashtu janë bërë angazhime nga organizatat si ONM, ONP dhe UNFPA. Regjistrimet e ardhshme do të kërkojnë përkrahje të madhe.

Disa zbritje në vlerësimet e shpenzimeve janë të mundshme në këtë plan zhvillimor, për shkak të përsëritjeve të projekteve në realizim ose të planifikuara. Prandaj është rekomaduar nga donatorët të realizojnë një hulumtim të mëtutjeshëm në këto projekte, të koordinohet financimi i tyre në lëmitë statistikore dhe të inkurajojnë bashkëpunim të ngushtë mes partive të ndryshme në sistemin statistikor.

### **9.2 Nga plani zhvillimor në planin realizues**

Ky plan zhvillimor ka qasje të kufizuar. Përparësi iu ka dhënë projekteve në vazhdim dhe të reja, propozim përkrahje dhe ndihmë të natyrave të ndryshme në një numër të pikave dhe jep rekomandime mbi mënyrat e punës. Por nuk jep ndonjë përshkrim të thellë dhe plane për projektet në vazhdim dhe nuk ka pasur mundësi të shqyrtoj kapacitetin e fuqisë ekzistuese ekonomike në marrëdhënie me projektet e planifikuara, në vijim apo të propozuara. Pra mbetin disa angazhime për tu bërë para se të keni planin realizues për udhëzimin dhe monitorimin e punës. Përgjegjësia kryesore për përgatitjen e planit të tillë të veprimit është në ESK.

### **9.3 Çështjet Qeveritare**

Për të siguruar realizim të sigurtë të planit zhvillimor dhe realizues të statistikave duhet të lëshohet nga Qeveria një vendim mbi planet ,pas përgatitjeve dhe përpunimit të duhur. Duhet të jetë e qartë se të gjitha ministratë janë në pajtim me planin dhe se ata janë të obliguar t'a zbatojnë atë. Masa speciale për përcjellje do të përfshihen në vendim. Ndryshimet e planit duhen të zbatojnë procesin e njëjtë dhe të vendoset nga Qeveria.

Komisioni Koordinues Statistikor për Kosovë është propozuar si një trup i rëndësishëm për përgatitje dhe diskutime në këtë kontekst.

## **10 Shtojcat**

**10.1 Termet e referencës**

**10.2 Enti i Statistikës së Kosovës (ESK) – Përshkrim i shkurtër**

**10.3 Personat e kontaktuar**

**10.4 Rendi i ditës për takimet me shfrytëzuesit/prodhuesit**

**10.5 Vlerësimet e shpenzimeve**